



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 7.11.2023, ora 10:00

Drejtton mbledhjen:

Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore lidhur me shqyrtimin projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” me institucionet: (*Komision për dhënie mendimi*)

1. Këshillin e Lartë Gjyqësor
2. Këshillin e Lartë të Prokurorisë
3. Inspektorin e Lartë të Drejtësisë
4. Komisionin e Pavarur të Kualifikimit
5. Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Jurgis Çyrbja, Klevis Xhoxhi, Toni Gogu, Damian Gjijnuri, Saimir Hasalla, Aurora Mara, Lavdrim Krrashi, Eduard Ndreca, Arben Pëllumbi, Bardhyl Kollçaku, Olta Xhaçka, Petro Koçi, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Arkend Balla, Dhurata Çupi, Greta Bardeli, Saimir Korreshi, Fatmir Xhafaj, Gledis Çeliku, Oerd Bylykbashi, Elda Hoti, Fatmir Mediu, Erisa Xhixho dhe Dashnor Sula.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Bledion Nallbati, Pandeli Majko, Ermonela Felaj, Gerta Duraku dhe Gazmend Bardhi.

Të ftuar:

Illir Rusi – zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Xhevdet Haxhiu – drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor

Emis Cerava – sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Dëshira Pasko – sekretar i Përgjithshëm i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Isida Koka – këshilltare e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Edmond Verçani – sekretar i Përgjithshëm i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Agim Paskali – drejtor Ekonomik dhe i Shërbimeve Mbështetëse pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Albana Pulaj – drejtoreshë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Sokol Çomo – kryetar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Laerta Rooze – sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Vilma Çausholli – përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Klotilda Bushka – Mirëdita, kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Sipas rendit të ditës të njoftuar, kjo mbledhje zhvillohet me mjete të komunikimit elektronik, me prezencën e kolegëve deputetë, që përbëjnë kuorumin e nevojshëm për vlefshmërinë e kësaj mbledhjeje.

Prezentë janë deputetët: Bardhyl Kollçaku, Arkend Balla, Klevis Xhoxhi, Arben Pëllumbi, Jurgis Çyrbja, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Lavdrim Krashi, Saimir Hasalla, Toni Gogu, Eduard Ndreca, Olta Xhaçka dhe unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, edhe zonja Aurora Mara.

Ndërkohë, sipas rendit të ditës për sot, ne do të vijojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Sekretarja e komisionit, zonja Vijola Sinaj, ndodhet me mua këtu.

Gjithashtu, prezente kemi zonjën Vilma Çausholli nga Ministria e Financave.

Ndërkohë, në vijim të shqyrtimit të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, sot kemi seancat dëgjimore me disa institucione, si: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit; pesë institucione.

Fillojmë me dëgjesën e parë, me Këshillin e Lartë Gjyqësor, përfaqësuesit e të cilit, zoti Ilir Rusi, zëvendëskryetar, dhe zoti Xhevdet Haxhiu, drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, janë prezentë *online*, ndërkohë relatorë për projektligjin e buxhetit të vitit 2024 vijojnë të jenë zoti Xhoxhi dhe zoti Hasalla.

Si rregull, ne do të dëgjojmë fillimisht përfaqësuesit e institucionit në lidhje me realizimin e buxhetit për vitin 2023 dhe nevojat për vitin 2024, për t’ua kaluar më pas fjalën relatorëve dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave, për të kuptuar si është situata dhe sa adresohen në projektbuxhetin e vitit 2024 nevojat e institucionit.

Zoti Rusi, fjala për ju.

Ilir Rusi – Përshëndetje, e nderuar zonja kryetare e komisionit!

Përshëndetje, të nderuar deputetë!

Sikundër e thatë edhe ju, sot kemi prezantimin e projektbuxhetit të vitit 2024, por, përpara se të kaloj tek objektivat, ia vlen të flasim për realizimin e buxhetit gjatë

dhjetëmujorit të vitit 2023, i cili në disa zëra me përqindje është realizuar rreth 70%, nga të cilat rreth 80% janë realizuar në shpenzimet korrente, **rreth 70%** është realizuar për rikonstruksionet e pjesshme dhe të plota të nëntë gjykatave dhe godinave gjyqësore.

Gjithashtu, një zë i porealizuar në masë të lartë, rreth 18%, janë investimet.

Po ta shikojmë në raportin 100%, ky 18% përbën vetëm realizimin e detyrave të projektimit në lidhje me ndërtimin e disa godinave të reja të gjykatave, konkretisht të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Apelit, Tiranë; të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë; Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier, dhe të asaj që është më e rëndësishme, Gjykatës së Lartë.

Në raport me parashikimet buxhetore për vitin 2024, vlen të theksohet fakti që buxheti, që është miratuar nëpërmjet VKM-së nr. 608 në tetor të vitit 2023, është pothuajse në të njëjtat nivele si buxheti i vitit 2023, ndërkohë që ne kemi kërkuar një vlerë monetare më të lartë si kërkesa buxhetore, që lidhen me tri programe buxhetore, që, në fakt, tashmë dihen.

Programi i parë lidhet me planifikimin, menaxhimin dhe administrimin e veprimtarisë së KLGJ-së.

Programi i dytë buxhetor ka të bëjë me mbështetjen e teknologjisë së sistemit të drejtësisë, e cila realizohet në Qendrën e Teknologjisë së Informacionit në lidhje me veprimtarinë e saj.

Programi i tretë dhe më i rëndësishmi është buxheti i gjykatave, për të cilin edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, si qeveria e gjyqësorit, ka për mision arritjen e objektivave përkatëse, sado që të gjithë së bashku kemi një qëllim, dhënien e një shërbimi sa më cilësor ndaj të tretëve, në këtë rast ndaj qytetarëve.

Po t'i shikojmë në zëra përkatës, buxheti i miratuar me këtë vendim të Këshillit të Ministrave është 35% më pak sesa buxheti i kërkuar nga ana jonë. Volumin më të madh në këtë përqindje e zë buxheti për gjykatat.

Në qoftë se do të bëja një zbrëthim sipas programeve buxhetore, në lidhje me buxhetin për planifikimin, menaxhimin dhe administrimin e veprimtarisë së KLGJ-së, ai është miratuar në një nivel më të ulët, prej 27%.

Po të shikojmë te zërat përkatës, ka një përqindje më të ulët në lidhje me fondin e pagave, duke pasur në konsideratë edhe rritjen e pagave të administratës civile gjyqësore, në raport me ndryshimet e fundit ligjore, dhe në lidhje me mbledhjen e pajisjeve për t'iu përshtatur teknologjisë së kohës, që është e fjalës së fundit.

Për sa i përket programit të dytë buxhetor, që ka të bëjë me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit, buxheti është në nivelin 11% më pak se ai i kërkuar nga ana jonë. Po t'i kemi

me zbatim zëri, ka të bëjë kryesisht me honorarët, shpërblimet, që jepen për anëtarët e bordit të Qendrës në fjalë, në raport me mbledhjet përkatëse.

Tani, “thembra e Akilit” apo vlera më e rëndësishme e këtij buxheti është ai për gjykatat, sepse në fund edhe ne, si Këshill i Lartë Gjyqësor, edhe Qendra e Teknologjisë së Informacionit, janë gjithmonë në shërbim të gjykatave.

Buxheti i miratuar për gjykatat për këtë vit në parashikimet tona është në nivelin 35% më pak sesa ajo që kemi kërkuar në 34%-35%, por që, po ta shikosh në përqindje, presumohet sikur është një e teta. Ama, duhet të kemi parasysh që në fondin e miratuar volumin më të madh e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore, sepse për këdo që punon është detyrim t’i jepet paga përkatëse.

Gjithashtu, vlen të theksohet edhe vendimi më i fundit i Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me pagën referuese bazë të magjistratëve gjyqtarë. Fondi që do të jetë si efekt financiar me parashikimet, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për diferencat e pagave të padhëna për magjistratët gjyqtarë nga 1 janari 2019 deri më 8 janar 2023, nuk është parashikuar si **(nuk kuptohet)** buxhetore në këtë buxhet, por i kemi kërkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të na miratojë një fond shtesë, me qëllim që të shkojë në destinacionin përkatës, në dhënien e diferencave të pagave të magjistratëve, duke iu referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila u konkretizua me një vendim së fundi, të nëntorit, të KLGJ-së në mbledhjet përkatëse plenare.

Nëse do të zërthej zërin “buxheti i gjykatave” sipas artikujve përkatës, do të thosha që volum të madh, me miratim shumë më të ulët, ka 13%-shi i miratuar në këtë zë. Pra, në raport me buxhetin e gjykatave, na janë miratuar 8 herë më pak sesa kemi kërkuar. Natyrisht, fondi i pagave nuk preket, por ajo që preket më shumë është fondi i investimeve përkatëse. Sepse tashmë është fakt publik që, edhe në zbatim të Hartës së re Gjyqësore, ka nevoja jo vetëm për rikonstrukcione, po edhe për ndërtimin e gjykatave të reja.

Në zërat përkatës, siç edhe e përmenda për vitin 2023, janë përfunduar detyrat e projektimit në lidhje me Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier, dhe Gjykatën e Lartë. Ndërkohë, duhet konkretizimi i tyre për ndërtimin e këtyre gjykatave, gjë e cila bëhet përmes fondeve për hartimin e planeve zbatuese të ndërtimit të godinave të reja të Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Apelit, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier, gjë e cila ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së shesheve apo të asaj që në termin popullor quhet “truall ndërtimi”, për ndërtimin e tyre. Sepse ka një mungesë të vënies në dispozicion të këtyre trojeve nga ana

e autoriteteve përkatëse (dihet se cilat janë këto të fundit sipas legjislacionit në fuqi), duke marrë në konsideratë edhe organizimin sipas qarqeve përkatëse.

Nëse do t'u referohemi zërave të tjerë, ne kemi një përqindje më të ulët të buxhetit të parashikuar në lidhje me projektim-zbatimin, dhe jo të vetë godinave, por ka nevojë edhe për ndërtimin e godinave të reja të gjykatave, siç janë: gjykata e Kukësit, gjykata e Lezhës, ajo e Lushnjës dhe ajo e Beratit. Dhe për këto paraqiten jo vetëm detyrat e projektimit, por paraqitet emergjent edhe hartimi i planeve zbatuese për ndërtimin e këtyre godinave të reja.

Vlen të theksohet, gjithashtu, fakti që në rastin e projekteve kemi hartuar edhe një strategji për rritjen e sigurisë dhe menaxhimin e godinës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Një përqindje më të ulët na e kanë miratuar në lidhje me logjistikën, që ka të bëjë me infrastrukturën përkatëse, sidomos edhe me teknologjinë e re të gjykatave, për pajisjet e nevojshme për ushtrimin e detyrës. Këto kërkesa duken ndoshta të tepërta në volumin ekonomik të tyre, por në raport të ushtrimit të një pune dinjitoze, kjo duhet bërë në një mjedis dinjitoz, jo vetëm për infrastrukturën në raport me zyrën që ushtron përkatësisht, por edhe në rritjen dhe sigurinë e tyre, po edhe me godina, sepse prezenca lidhet edhe me facilitetet përkatëse. Duke siguruar një mjedis dinjitoz, sidomos për magistratët, të cilët, edhe për shkak të funksionit, kryejnë një detyrë tejet të rëndësishme dhe kanë një mision në dhënien e përgjegjësisë, atëherë mendoj se ai kriteri i përgjithshëm, performanca, po edhe dukja e punës sonë do të jetë në nivele më të larta.

Pra, vlen të theksohet edhe fakti që na është miratuar dy e treta e buxhetit, një e treta jo, por ky fond është i destinuar kryesisht për investime që përkthehen në kapitale, qoftë në logjistikë apo edhe në godina, sepse volumin më të madh e zë niveli i pagave dhe sigurimeve shoqërore, nisur nga fakti që në sistemin gjyqësor, ku numri i përgjithshëm është 408 gjyqtarë, nga të cilët 332 janë *de facto*, të cilët janë ata që ushtrojnë detyrën e përditshme në gjykata, por janë ata që, për shkak të një procesi transitor të vetingut, janë në arkivat e KPK-së, ndërkohë u jepet niveli i pagës 75%.

76 vakanca janë të përhershme në radhët e gjyqtarëve.

Për sa u përket nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë, është kufiri 1207, për shkak të Hartës së Re Gjyqësore për riorganizimin, nga të cilat 1004 janë efektivisht në punë dhe 203 janë vakanca.

Pra, dua të them që pjesën më të madhe të konvertuar në lekë e zë fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe lihen mënjanë më të rëndësishmet, investimet e mëtejshme. Jo vetëm për nevojën e hartës së re gjyqësore, por edhe të nevojës së përditshmërisë, duke ditur faktin që edhe këto godinat nuk janë tipikisht për të ushtruar funksionin e gjykatës që ditën e

parë, por kanë qenë godina për shërbime të tjera dhe, për shkak të nevojave, janë marrë në përdorim nga ana e ish-KLD-së (tani KLP-ja), me qëllim që të ushtrohet funksioni i gjykatave. Por edhe godinat që mund të jenë ekzistuese nuk kanë funksionin e vërtetë të një gjykate, me përjashtim të disa gjykatave që janë ndërtuar kohët e fundit.

Edhe nga marrëveshja që kemi bërë në raport me Prokurorinë e Përgjithshme për shkak të zbatimit të Hartës së re Gjyqësore, pothuajse kemi rakorduar në lidhje me përdorimin në të ardhmen të objekteve nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si gjykatave apo edhe godinave të tjera. Pritet që, nëpërmjet ndërhyrjes së Ministrisë së Drejtësisë dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të kthehen në prona tonat, me qëllim që të kemi më shumë mundësi t'i përshtatim ato gjykata.

Gjithashtu, edhe në fondin e parashikuar për rikonstruksionin e pjesshëm apo të plotë të disa gjykatave, si Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Berat dhe Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë mbulohet rikonstruksioni i tyre, por përsëri fondi i miratuar është në nivele shumë më të ulëta nga sa kemi kërkuar. Vlen të theksohet fakti që te zëri “gjykatat” është miratuar vetëm 80% e buxhetit.

Këto ishin piketat kryesore, sepse ne jua kemi bërë me dije prej kohësh, edhe të zbërthyer në shifra ekonomike, përmes një shkrese zyrtare ditën e djeshme, që besoj se u është shpërndarë deputetëve të nderuar dhe e kanë përpara. Ndaj zgjodha që prezantimi im të ishte në nivele përqindjeje për të qenë sa më i kuptueshëm për ata që na dëgjojnë dhe jo në nivelin e vlerave ekonomike, sepse, kur përdor vlerat ekonomike, duket sikur janë shuma të mëdha, por në vetvete, nëse ato materializohen në shërbime, në pajisje, në godina dhe në paga, nuk rezultojnë efektive në lidhje edhe me qëllimin e tyre.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Rusi!

Ndërkohë, para se t'ua jap fjalën relatorëve, dua të bëj vetëm një njoftim.

Në nisje të mbledhjes, kanë qenë prezentë edhe zoti Damian Gjikhuri, edhe zoti Fatmir Xhafaj, por unë nga shpejtësia nuk i përmenda emrat e tyre.

Atëherë, kush do ta marrë fjalën nga relatorët?

Po, zoti Xhoxhi.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit, zonja kryetare!

Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë!

I nderuar zoti përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor,

Më lejoni që në krye të fjalës sime të them që projektbuxheti i parashikuar për Këshillin e Lartë Gjyqësor, si edhe ai për të gjitha institucionet e tjera, që janë nën

përgjegjësinë e komisionit tonë, atij të Ligjeve, është një buxhet në rritje në krahasim me vitin 2023.

Buxheti në total i parashikuar për vitin 2024 për Këshillin e Lartë Gjyqësor është rreth 4,83 miliardë lekë, nga të cilat 3,89 miliardë lekë shkojnë për zërat “shpenzime”, “paga dhe sigurime shoqërore”, 689 milionë lekë shkojnë për zërin “shpenzime për mallra dhe shërbime” dhe 250 milionë lekë shkojnë për zërin “shpenzime për investime”. Ndërkohë, numri i punonjësve të KLGJ-së për vitin 2024 është parashikuar të jetë rreth 1759.

Po të bëjmë një krahasim me buxhetin e vitit 2023, rezulton se shpenzimet totale të KLGJ-së janë rritur në rreth 472 milionë lekë ose me 10,8% më shumë, të ndara këto në shpenzimet korrente në vlerën 953 milionë lekë ose 26% më shumë, ndërsa në zërin “shpenzime për investime”, në fakt, ka rënë me 481 milionë lekë ose 65,8%.

Në fakt, e theksoi edhe zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ajo që të bën përshtypje është se nga të gjitha fondet, pra nga realizimi i buxhetit për vitin 2023, konstatohet që shpenzimet për investime janë realizuar vetëm në masën 16,85, pra diku te 17%.

Pavarësisht kësaj, qoftë edhe nga kërkesat që zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor paraqiti duke bërë një panoramë të detajuar të të gjithë projektbuxhetit, pra edhe të kërkesave për vitin 2024, bashkë me Ministrinë e Financave, me të cilën do t’i diskutojmë, po edhe pas diskutimeve tuaja, kolegë, do të mbetemi të hapur për sugjerime dhe marrjen parasysh të të gjitha kërkesave, për t’ia përcjellë më pas Komisionit të Ekonomisë, që është edhe komisioni përgjegjës për miratimin e projektbuxhetit.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Fjalën e ka zonja Vilma Çausholli nga Ministria e Financave, lidhur me treguesit financiarë të vitit 2023 për Këshillin e Lartë Gjyqësor, kërkesat për vitin 2024 dhe adresimin e tyre në buxhet.

Kini parasysh, kolegë, që ne po flasim për një buxhet, i cili plotëson nevojat prioritare dhe do të duhet të shohim po në këtë kuadër se si janë adresuar këto nevoja dhe nëse ka vend për përmirësime. Gjithsesi, Ministria e Financave mund të na japë një mendim që të jemi më të qartë në lidhje me këtë çështje.

Zonja Çausholli, fjala për ju!

Zonja Çausholli, nuk dëgjoheni.

Zonja Çausholli, shihni nëse e keni hapur mikrofonin në pajisjen tuaj elektronike.

Teknika më thotë që duhet të keni kufjen me problem. Mund të përdorni audion e pajisjes elektronike, të kompjuterit.

Presim disa minuta kolegë sa të zgjidhet problemi teknik.

Zonja Çausholli njofton se do të përpiqet ta kryejë lidhjen nga telefoni.

Presim disa çaste.

Kolegë, duke qenë se zonja Çausholli do të prezantojë në emër të ministrisë për të gjitha institucionet, sa teknika të zgjidhë problemin me zonjën Vilma, dhe ajo na ndjek, a të vijojmë me prezantimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe më pas zonja Çausholli e merr fjalën për të dyja institucionet? A jeni dakord?

Dakord.

Kush ka kundërshtim të kërkojë fjalën.

Në rregull.

Atëherë, vijojmë me prezantimin dhe pastaj do të bëjmë diskutimin për të dyja institucionet bashkë.

Vazhdojmë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me zotin Emis Çërava, sekretar i Përgjithshëm.

Zoti Çërava, jeni *online*?

Fjala për ju.

Emis Çërava - E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka një buxhet modest në krahasim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, pasi ka vetëm 4% të të gjithë buxhetit të prokurorisë, sepse ne kemi vetëm aktivitetin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke qenë se Prokuroria e Përgjithshme dhe SPAK-u kanë buxhete të ndara që menaxhohen nga vetë institucionet.

Për vitin 2023, për këtë 10-mujor, vlen të theksohet se Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka realizuar në masën 87% shpenzimet për paga dhe sigurime, 91% për llogarinë e shpenzimeve operative dhe 53% për investimet, duke bërë një planifikim që deri në fund të vitit të gjithë zërat do të jenë realizuar në masën 99% ose 100%.

Në lidhje me vitin 2024, falënderojmë Ministrinë e Financave për suportin dhe bashkëpunimin. Nuk kemi ndonjë kërkesë specifike për investimet apo për pagat, pasi janë reflektuar ndryshimet si të pagës së re referuese për magistratët, ashtu edhe nëpunësit civilë të Këshillit. E vetmja gjë ku kemi një mangësi është te shpenzimet operative, pasi kërkesa jonë ka qenë 35 milionë lekë të rinj, ndërkohë janë aprovuar 25 milionë lekë të rinj. Duke

parë historikun e shpenzimeve operative që janë standard, themi që kjo kërkesë është minimale, për të pasur në mënyrë sa më eficiente funksionimin e Këshillit.

Gjithashtu, dua të ngre një çështje tjetër, siç e ngriti edhe zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, që Ministria e Financave duhet të marrë në konsideratë diferencën e pagës së magistratëve për periudhën 1 janar 2019 deri në datën 8 janar 2023, pasi nuk është marrë në konsideratë. Nuk e di nëse Ministria e Financave ka ndonjë plan, por shqetësimi që ngre, ka të bëjë me faktin që, duke qenë se gjykatat po japin vendime të ekzekutueshme për këto diferenca, ekzekutimet e tyre do të na bllokojnë komplet zërin e shpenzimeve operative, duke sjellë pastaj edhe ndërçështje në funksionimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, por edhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë së Përgjithshme apo edhe SPAK-ut. Për këtë arsye, Ministria e Financave, për mendimin tim duhet të bëjë një plan, që njerëzit të jenë të qartë, në mënyrë që të mos kemi ekzekutime, pasi vetëm një ekzekutim mund të shkojnë deri 3,9 milionë lekë, gjë që për Këshillin e Lartë të Prokurorisë është vlerë e madhe, pasi me buxhetin modest që kemi, do të bllokohemi komplet për funksionin normal dhe pagesën e shpenzimeve korrente.

Nuk kam gjë tjetër për të thënë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Çërava!

Zoti Xhoxhi, në lidhje me KLP-në dhe më pas ia japim fjalën zonjës Çausholli për të dyja institucionet.

Klevis Xhoxhi - Faleminderit, kryetare!

Faleminderit përfaqësuesit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë!

Edhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë për vitin 2024 në projektbuxhet është parashikuar një vlerë rreth 209 milionë lekë nga të cilat 173,6 milionë lekë do të jenë për shpenzime dhe paga/sigurime shoqërore; 25,4 milionë lekë do të jenë shpenzime për mallra dhe shërbime, ndërsa 10 milionë lekë do të jenë shpenzime për investime. Ndërkohë, numri i punonjësve për KLP-në për vitin 2024 është parashikuar të jetë 72 punonjës. Edhe këtu po të bëjmë një krahasim me buxhetin e vitit 2023 rezulton që shpenzimet totale të KLP-së janë rritur me 36,4 milionë lekë ose 21,1% më shumë, nga të cilat shpenzimet korrente janë rritur me 41,4 milionë lekë ose 26,3% më shumë, ndërsa shpenzimet për investime kanë rënë. Pra, edhe këtu kemi një rënie të shpenzimeve për investime në 5 milionë lekë ose 33,3% më pak. Ndërsa, numri i punonjësve, në krahasim me vitin 2023 është i pandryshuar.

E përmendi pak edhe përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që 9-mujorin e vitit 2023 buxheti është realizuar në masë 78,2%, nga të cilat shpenzimet korrente në masën 80,5% dhe shpenzimet për investime në masën 54%.

Duke dëgjuar përfaqësuesit e Ministrisë së Financave për Këshillin e Lartë të Prokurorisë bashkë me sugjerimet tuaja, kolegë, sikundër e thashë në kërkesat që bëri edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, edhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë do të plotësojmë kërkesat që bëri përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për t'ia adresuar pastaj Komisionit të Ekonomisë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Zonja Çausholli, jeni në linjë?

Na keni ndjekur besoj.

Përpuquni të hyni!

Teknika e Kuvendit, hapni mikrofonin, që të marrë fjalën zonja Çausholli!

Atëherë, zonja Çausholli, pranoni njoftimin e teknikës në pajisjen tuaj elektronike për audion.

Zonja Çausholli, nuk ju dëgjojmë.

Ndërkohë që teknika merret me çështjen teknike të zonjës Çausholli, a keni pyetje kolegë, përpara se ta marrë fjalën zonja Çausholli?

Po, zoti Çyrbja.

Fjalën e ka zoti Çyrbja për pyetje.

Jurgis Çyrbja – Përshëndetje të nderuar kolegë!

Kam një pyetje për zotin Rusi si nënkryetar i KLGJ-së.

Dëgjova që keni planifikuar disa investime për disa godina gjyqësore të gjykatave të Tiranës, të apelit, për Gjykatën e Lartë apo edhe për atë të Fierit. Dua të di, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, a keni planifikuar ndonjë investim? Sepse gjykata e Durrësit është në kushte të amortizuara dhe jo funksionale, siç duhet të jetë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Çyrbja!

Fjala për zotin Rusi.

Illir Rusi – E falënderoj zotin Çyrbja për ndërhyrjen.

Duke e lidhur edhe me konstatimin e zotit Xhoxhi, niveli i realizuar i investimeve deri tani në nivelin 80% ka të bëjë, pikërisht, me mosrealizimin e projekteve për zbatimin e ndërtimit të godinave të reja. Kemi përfunduar vetëm detyrat e projektimit për këtë fond. Për shkak të mungesës së truallit ka mbetur i paplanifikuar projekti për zbatimin e ndërtimit të gjykatave. Unë po i përmend gjykatat nga vendndodhja fizike aktuale: Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshme e Apelit, Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykata e

Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Pra, kjo do të thotë se në prioritet tona është parashikuar edhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, por për mungesë trualli ka mbetur i pa implementuar, i pa vazhduar hartimi i projektit për zbatimin e ndërtimit të këtyre godinave në këto momente. Kështu që, edhe në këto dëgjesa vlen të theksohet fakti që të gjithë duhet të ndërgjegjësohemi dhe të përpiqemi si organe vendore dhe qendrore për të gjetur trojet përkatëse për të ndërtuar këto godina.

Megjithatë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka edhe një specifike, sepse në të më përpara ka funksionuar edhe Gjykata e Apelit Durrës, që tashmë është pjesë e Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Apelit Tiranë. Kështu që, godina e saj është e lirë dhe është projektuar për t'u përdorur nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Gjykata aktuale të jetë një nga dhomat përkatëse, dhomë penale ose civile, sipas prioriteteve të funksionimit të saj dhe ish-godina e Gjykatës së Apelit Durrës të shërbejë si ambiente penale apo civile sipas vendimmarrjeve që merr vetë gjykata. Ne kemi projektuar edhe marrëveshjen e bërë me Prokurorinë e Përgjithshme dhe i kemi rakorduar godinat që do të përdorim në të ardhmen.

Pra, në respekt të pyetjes dhe përgjigjes dua ta perifrazoj me dy fjali: Për sa i përket Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, jo vetëm që është në planet tona për t'u ndërtuar një godinë e re, edhe pse ky projekt ka mbetur i pa implementuar më tej për shkak të mungesës së truallit për të bërë një projekt për zbatimin e ndërtimit, por paralelisht me të Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka mundësi që të përdorë edhe ish-godinën e gjykatës së apelit dhe të bëjë një organizim të vetin për të ndarë dhomat penale dhe civile sipas nevojave dhe trupave gjyqësore përkatëse.

Klotilda Bushka - Faleminderit, zoti Rusi!

Po, zonja Çausholli.

Vilma Çausholli – Më dëgjoni?

Klotilda Bushka – Po. Fjala për ju në lidhje me kërkesat e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Vilma Çausholli – Ju kërkoi ndjesë për ndërprerjen.

Për sa i përket buxhetit të Këshillin e Lartë Gjyqësor, në vitin 2024, sikurse edhe relatori e tha pak më parë, totali i shpenzimeve të buxhetit për Këshillin e Lartë Gjyqësor është rritur me 10,8% dhe rritje të konsiderueshme në këtë zë kanë shpenzimet e personelit, që janë rritur me 32,2%. Duhet thënë se kemi një ulje në grupin e shpenzimeve për investime. Ato janë shpenzime shumë të rëndësishme për KLGJ-në dhe ne jemi në dijeni të

problematikave dhe kërkesave të vazhdueshme për investime që KLGJ-ja ka bërë për vitin 2024. Kërkesa shtesë për vitin 2024 është rreth 2 miliardë lekë për shpenzime kapitale, nga të cilat janë miratuar 250 milionë lekë. Arsyet lidhur me këtë planifikim të fondeve të investimeve janë të lidhura shumë edhe me realizimin faktik jo vetëm të vitit 2023 në buxhetin e investimeve për KLGJ-në, por nëse do ta shikojmë në një kuadër më të gjerë, të shtrirë në disa vite, mund të themi se që nga viti 2016 fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për investime deri në vitin 2023 janë 2,3 miliardë lekë dhe realizimi ka qenë gjithmonë as në masën 50%. Pra, realizimi është rreth 1,3 miliardë lekë.

Kështu që, nga ana jonë është gjykuar që në vitin 2024 të mundësohet realizimi i fondeve të dhëna në vitin 2023, në mënyrë që pastaj të shikohet edhe mundësia e ngritjes së godinave të reja. Në qoftë se këto investime për ndërtimin e gjykatave të rretheve kapin një vlerë mbi 500 milionë lekë, nga ana e KLGJ-së duhet të bëhen edhe kërkesat përkatëse për të ndjekur procedurën për investime të tilla, që kapërcejnë vlerën e 500 milionë lekëve.

Lidhur me shpenzimet operative në buxhetin e KLGJ-së, si në të gjitha institucionet e tjera është mbajtur pothuajse i njëjti nivel, duke marrë në konsideratë një rritje të vogël prej 4 milionë lekësh, por vlerësohet që buxheti i KLGJ-së për vitin 2024 plotëson të gjitha mundësitë për të zhvilluar një veprimtari për të pasur një ecuri normale të institucionit. Këto ishin komentet tona për kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka, gjithashtu, një rritje. Është një institucion i vogël konsideruar me Këshillin e Lartë Gjyqësor, por në vitin 2024 është planifikuar me rritje, që në totalin e shpenzimeve përfaqëson një rritje prej 21,1%. Janë të plotësuara shpenzimet për personelin e institucionit dhe konstatojmë se në vitin 2024 buxheti i këtij institucioni është rritur me rreth 40 milionë lekë. Të gjitha rritjet e shpenzimeve të personelit për këto institucione lidhen me reformën e pagave si për magjistratin ashtu edhe për reformën e realizuar në administratën e institucionit. Pra, janë rakorduar fondet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së institucionit.

Shpenzimet operative kanë rritje të vogël, por konsiderohen të mjaftueshme për të zhvilluar një veprimtari normale të institucionit. Kaq kishim për të thënë për kërkesat e këtyre dy institucioneve dhe projektbuxhetin e parashikuar nga ana jonë.

Klotilda Bushka - Faleminderit, zonja Çausholli!

Qëndroni në linjë, sepse do të kemi edhe institucionet e tjera për të cilat do të duhet pa diskutim edhe komenti juaj.

Kolegë, keni ndonjë pyetje?

Toni Gogu - Kam unë një pyetje.

Klotilda Bushka – Po, zoti Gogu.

Toni Gogu – Zoti Rusi, ju thatë se investimet janë realizuar në nivelin 18%. Edhe zonja Çausholli, gjithashtu, tregoi se kjo është në disa vite. Pra, realizimi i ulët është në disa vite. Në fjalën tuaj ju shpjeguat që realizimi i investimeve ka qenë i ulët për shkak të mungesës së shesheve të trojeve. Ju kam kuptuar drejt?

Ilir Rusi - Po, zoti Gogu.

Toni Gogu – Atëherë, kam një pyetje për ju. Tani që ne flasim keni troje të përcaktuara nga autoritetet lokale?

Ilir Rusi – Pyetja juaj është shumë sintetike ndaj dhe përgjigjja ime do të jetë sintetike.

Klotilda Bushka - Zoti Gogu, aq ishte pyetja?

Toni Gogu - Për momentin po.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Gogu!

Po, zoti Rusi.

Ilir Rusi – Kam një përgjigje shumë sintetike. Jo, nuk kemi troje të projektuara nga pushteti vendor me qëllim që të ndërtojmë godinat e gjykatave.

Toni Gogu – Atëherë, pse kërkon para për investime kur nuk keni troje? Pra, a nuk duhet të siguron njëherë trojet dhe pastaj të kërkon investime, sepse nëse arsyeja e vetme e mosrealizimit të investimeve është mungesa e trojeve, ky duket si një rreth vicioz?

Ilir Rusi - Më lejoni t’ju jap një përgjigje të tillë. Projektbuxheti është “projektbuxhet afatmesëm 2024-2026”. Në momentin që bëhet projektbuxheti, dhe unë po e konsideroj veten sikur jemi anëtarë të një shtëpie të madhe, ne projektojmë sa shtëpi të tjera kemi, që në këtë rast janë gjykatat. Nëse janë fondet përkatëse, nëse janë burimet njerëzore përkatëse dhe nëse është edhe një truall është shumë më e lehtë të bësh një projekt për zbatimin e ndërtimit përkatës dhe pastaj të fillohet implementimi i ndërtimit.

Të gjitha këto që përmendëm ne bëjnë fjalë për institucione shtetërore, të cilat me një koherencë komunikimi dhe bashkëpunimi ...

Koha është shumë relative, aq më tepër që projektbuxheti është afatmesëm 2024-2026, duke filluar nga viti 2024 dhe më tej. Këto kërkesa të përsëritura nuk janë nga mungesa hipotetike e truallit, por nga nevoja që ne kemi për të ndërtuar këto godina.

Meqenëse m’u drejtuar edhe me emër, sipas direktivave përkatëse të dhëna nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për të bërë një inspektim të të gjitha gjykatave, unë kam bërë një inspektim personal pothuajse në të gjitha gjykatat dhe e kam parë nga afër situatën. Ne përmendëm qytetet ku do të ndërtohen godinat gjykatave, por nëse do të vlerësojmë një

situatë të përgjithshme në të gjitha rrethet ku ka godina të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm është e nevojshme që pjesa më e madhe e tyre të ndërtohen nga fillimi për faktin se ato kanë qenë godina për shërbime të tjera dhe janë përshtatur në gjykata.

Dihet se çfarë do të thotë tani funksionaliteti i gjykatës. Nuk ka të bëjë vetëm me zyrën e gjyqtarit, por ka të bëjë me të gjitha fasilitetet përkatëse me qëllim që edhe qytetari, kushdo qoftë, që ka një konflikt civil, administrativ apo penal të jetë dinjitoz kur shkon në dyert e gjykatës.

Kështu që, ne jemi pragmatistë dhe kemi parashikuar ndërtimin e disa godinave që e kanë nevojë emergjente, por po të bëjmë një studim real, të gjitha godinat kanë nevojë për rikonstruktohen, siç kemi parashikuar rikonstruksionin e Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në Korçë, Fier, Berat dhe asaj të apelit. Për t'u ndalur te gjykata e Apelit, projeksioni është të ketë 78 gjyqtarë. Aktualisht ajo godinë nuk mund të akomodojë 78 gjyqtarë, me gjithë nëpunësit civilë gjyqësor dhe punonjësit e tjerë, për të mos folur edhe për sallat e gjykimit, që duke pjesëtuar numrin e trupës gjyqësore me tri veta do të duhen 24-25 salla gjykimi.

Këto janë projeksione për të ardhmen dhe ne, për shkak të nevojës, duhet t'i parashtrijmë jo në mënyrë hipotetike, por duke bashkëpunuar të gjithë se bashku, sepse, siç e thashë edhe në fillim, koha është shumë relative.

Toni Gogu - Zonja kryetare, mund të bëj edhe një pyetje të fundit?

Klotilda Bushka - Po, zoti Gogu.

Toni Gogu – Zoti Rusi, unë ju kuptoj plotësisht kur thoni që një pjesë e madhe e godinave ekzistuese nuk janë projektuar për gjykata dhe për pasojë nuk kanë parashikuar aksesin e publikut, hyrjen e veçantë të pandehurit, arkivat, hapësirat për arkivat, qendra teknologjike e kështu me radhë.

Pyetja që unë kam është kjo: A keni projekte ristrukturimi të godinave ekzistuese, që nuk kanë nevojë për truall tjetër, dhe nëse po, pse nuk i keni realizuar, sepse me sa po shikoj fondet kanë qenë?

Ilir Rusi - Faleminderit, zoti Gogu!

Nëse do t'i referohemi vitit 2023, zëri i rikonstruksioneve të plota apo të pjesshme në gjykata është realizuar deri më tani në masën 77%. Jemi në muajin e njëmbëdhjetë dhe deri në fund të vitit, kur kemi edhe dy muaj kohë, do të shkojmë në nivelin 100% të realizimit të fondit të dedikuar për rikonstruksionin e plotë apo të pjesshëm të 9 gjykatave.

Përveç këtyre, në projeksionin e projektbuxhetit 2024 kemi projektuar një rikonstruksion të pjesshëm të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

Korçë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjykatës së Apelit në Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me qëllim që ne të bëjmë ristrukturimin e tyre për të përshtatur sa më shumë fasilitetet përkatëse në shërbim të qytetarit, pavarësisht për çfarë çështjeje paraqitet ai në gjykatë.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Rusi!

Zoti Gogu nuk ka më pyetje.

Ju lutem, pjesëmarrësit *online* të mbyllin audion, sepse dëgjohen bisedat në zyrat e tjera ndërkohë që duhet të ndjekim mbledhjen.

Ka pyetje të tjera, kolegë?

Zoti Çyrbja, keni pyetje?

Fjala për zotin Çyrbja. Më pas do të bëj unë pyetje.

Jurgis Çyrbja – Kam një sugjerim për zotin Rusi, meqenëse tha se projektin e gjykatës së Durrësit e kanë të bërë, por nuk kanë truall. Ju sugjeroj të shikoni truallin e ish-Gjykatës së Apelit Durrës, pasi është një vend tejet i përshtatshëm dhe godina është tejet e amortizuar edhe nga tërmeti i nëntorit.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Po, zoti Rusi.

Ilir Rusi – Ne jemi juristë dhe terminologjia duhet përdorur ashtu siç është.

Ne thamë se kanë përfunduar detyrat e projektimit. Tani duhet identifikuar trualli. Duke marrë parasysh të gjithë koeficientet e ndërtimit mbi atë truall, të projektohet projekti për zbatimin e ndërtimit. Pra, janë dy gjëra të ndryshme.

E para, janë detyrat e projektimit për të nxjerrë volumet e ndërtimit dhe hapësirat se si ndahet ajo dhe pastaj ajo do të materializohet në një truall si projekt për ndërtimin e saj. Më pas vjen faza e tretë, kur fillon ndërtimi.

Trualli që sugjeroi zoti Çyrbja është në konsideratë, por kemi ende një grup pune të përbashkët ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Kemi rakorduar mbi ndarjen e godinave ekzistuese aktualisht, por që ne të disponojmë truallin duhet të jemi pronarë dhe titullin e pronësisë mbi ato troje të prezumuara që janë troje të lira nuk e ka ende Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Klotilda Bushka - Faleminderit, zoti Rusi!

Në fakt, kolegët deputetë, duke qenë se vijnë nga zonat përkatëse, mund të japin sugjerime, por edhe mund të ndihmojnë në lehtësimin e këtij komunikimi ndërinstitucional

kur vjen puna te pengesat që shfaqen për mosgjetjen trojeve, që janë kryesisht nën administrimin e pushtetit vendor.

Gjithsesi, ne këtu nuk do të zgjidhim hapat, por po merremi me çështjet buxhetore.

Unë kam disa pyetje për ju, më shumë në kuadër të lehtësimit që komisioni mund të bëjë.

E para, harta gjyqësore është një nga reformat më të rëndësishme pjesë e zbatimit të reformës në drejtësi dhe kur është miratuar vendimi për hartën gjyqësore ka pasur një buxhet afatmesëm.

Është e drejtë ajo që thoni ju, zoti Rusi, që ka pasur një buxhet, i cili ndahet në vite dhe fillohet me fazat: në fillim është detyra e projektimit, projekti, e më pas, paralelisht me këtë, gjetja e truallit, nëse bëhet fjalë për ndërtime të reja, si dhe vijimi i procedurës për realizimin e ndërtimit.

Unë dua t'ju pyes: për buxhetin e vitit 2023 në komision kemi diskutuar gjerë e gjerë dhe si pjesë e buxhetit është miratuar edhe projekti për Gjykatën e Lartë dhe për disa gjykata të tjera, pra janë dhënë fonde për projektimin. Ndërkohë, janë dhënë fonde për riparimin e gjykatave aktuale, të cilat do të përshtateshin derisa të ndërtoheshin godinat e reja në zbatim të hartës së re gjyqësore, si dhe janë kërkuar nga ju shpenzime në lidhje me gjykatat ekzistuese. Shoh që nivelin e investimeve për riparimin e gjykatave ekzistuese e keni të lartë. Pyetja është: cilat nga projektet që kërkuat në vitin 2023 janë tashmë realizuar, pra detyrat e projektimit, për shembull, Gjykata e Lartë?

Fjala është për zotin Rusi.

Ilir Rusi – Në lidhje me përfundimet e projektimit të tyre, ka përfunduar Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Klotilda Bushka – Pyetja tjetër: për truallin për Gjykatën e Lartë dhe për gjykatat e tjera, për të cilat në mbledhjen e mëparshme të komisionit, kur diskutuam buxhetin e vitit 2023, u kërkuar edhe ndihma e komisionit për mundësimin e tij, në çfarë faze jeni?

Ilir Rusi – Jemi në fazën e bashkëbisedimit, por nuk ka një përfundim të konkretizuar me një truall të lirë përfundimtar për të bërë një projekt për zbatimin e ndërtimit të tyre.

Klotilda Bushka – Do të na duhet një informacion i detajuar me shkrim nga ju në lidhje me këtë çështje, pra jo vetëm për truallin për Gjykatën e Lartë, por edhe për trojet e tjera, që ju kërkon për realizimin e godinave në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore.

Sa i takon realizimit të projektit për godinën e re të gjykatave të reja, a parashikoni zëra në buxhetin afatmesëm të vitit 2024?

Ilir Rusi – Absolutisht që parashikojmë një fond për projektimin dhe zbatimin e tyre, si dhe për ndërtimin e Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier.

Klotilda Bushka – Ndërkohë, a jeni rakorduar me Prokurorinë e Përgjithshme, sepse, sipas zbatimit të hartës gjyqësore, por edhe parimit të eficiencës, në komision kur janë shqyrtuar çështjet e buxhetit është diskutuar se ju do të rakordoheni që të keni godina atje ku mundeni bashkë? A keni tashmë një rezultat të kësaj pune? Me sa keni raportuar në mbledhjet e kaluara, e keni nisur, por a keni një rezultat të rakordimit për këtë çështje?

Ilir Rusi – E nderuar kryetare, meqë përmendët hartën e re gjyqësore, kam pasur fatin të jem në pjesën fundore të miratimit të hartës, po, kam qenë 100% në zbatimin e saj. Tashmë jemi me një grup pune për uljen e çështjeve të prapambetura, që kanë të bëjnë me *backlog*-un.

Në lidhje me zbatimin e hartës së re gjyqësore, patjetër që kemi një rakordim, pothuajse përfundimtar me Prokurorinë e Përgjithshme, sepse edhe dy situatat që kemi pasur me Prokurorinë e Përgjithshme në lidhje me godinën e ish-prokurorisë, ish-gjykatës së rrethit gjyqësor në Lushnje dhe ish-prokurorisë në Gjirokastrë, kemi bërë inspektime në vend për realizimin e tyre. Detyra dhe projektimi i tyre janë të përbashkëta në lidhje me përdorimin e godinave në të ardhmen, si nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, ashtu dhe nga ana e gjykatës.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Rusi!

Sa i takon KLP-së, besoj se çështjet janë të qarta.

Për shpenzimet operative, shoh që bëhet fjalë për vlera fare të vogla. Këto janë çështje që rakordohen sipas rregullave që ka edhe hartimi i buxhetit, kështu që mendoj të mos ndalemi në këtë moment.

Meqenëse nuk ka më diskutime, ne do të vijojmë me një përmbledhje të dy dëgjesave të para. Unë do të thosha që, nisur nga mënyra se si është hartuar buxheti i vitit 2024, që janë parimet e përhershme, ato që lidhen me aftësinë zbatuese të institucioneve të buxhetit të vitit të kaluar, ato që lidhen me prioritetet e buxhetit dhe me mundësitë buxhetore, relatorët dhe institucionet të rakordohen me Ministrinë e Financave, që të shihet se cilat janë nevojat që duhet të adresohen më mirë, apo të sqarohet nëse janë adresuar ashtu si duhet, që në fund të kemi një qartësi të nevojave që kanë institucionet për Komisionin e Ligjeve, që të ndihmojë në këtë ndërveprim institucional, bie fjala, për trojet. Pra, ne nuk mund vazhdojmë ta bëjmë këtë diskutim herë pas here dhe kjo çështje të mbetet e pazgjidhur. Mendoj se tashmë që është ecur me detyrat e projektimit, çështja e trojeve duhet të zgjidhet sa më parë.

Zoti Rusi, faleminderit!

Faleminderit, zoti Cerava!

Jeni të lirë të dilni nga mbledhja, ndërkohë që ne vijojmë me dëgjuesën tjetër.

Ilir Rusi – A mund të them diçka në mbyllje?

Klotilda Bushka – Po.

Ilir Rusi – Meqenëse ishte edhe KLP-ja në raportim, vlen të theksohet niveli i lartë i bashkëpunimit që kemi me Prokurorinë e Përgjithshme për të qenë sa më efektivë. Është një projekt i përbashkët ndërmjet Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe prokuroritë përkatëse për të qenë në një godinë të vetme, por në raport me truallin, mund të jetë një projekt i përbashkët, por mund të jetë edhe i veçuar. Ne kemi menduar që, edhe për lehtësi të qytetarëve, të jenë në një godinë, të paktën këto gjykata të rëndësishme dhe prokuroritë e Tiranës.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Rusi!

Në fakt, kjo këshillohet nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë sa herë që këto çështje janë objekt diskutimi.

Faleminderit!

Vijojmë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Kemi të pranishme zonjën Dëshira Pasko, sekretare e Përgjithshme, dhe zonjën Isida Koka, këshilltare.

Zonja Pasko, ju keni qenë *online*, na keni ndjekur, kështu që keni fjalën në lidhje me realizimin e buxhetit të vitit 2023, nevojat buxhetore të vitit 2024 dhe si janë adresuar ato.

Dëshira Pasko – Faleminderit, zonja kryetare e Komisionit të Ligjeve!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Në mënyrë të përmbledhur po jap fillimisht realizimin e buxhetit për vitin 2023 dhe më pas do të vazhdoj me një prezantim të shkurtër të kërkesave buxhetore të institucionit për vitin 2024.

Klotilda Bushka – Zonja Pasko, ndjesë!

Teknika, disa deputetë të komisionit thonë që nuk hyjnë dot në mbledhje.

Ju lutem, asistojini!

Zonja Pasko, vijoni.

Dëshira Pasko - Ecuria e realizimit të treguesve buxhetor për vitin 2023 ka qenë si më poshtë:

Për zërin “Paga dhe sigurime” deri në fund të vitit 2023 do të realizohet 70% e zërit, për shkak të buxhetit vjetor të planifikuar, si dhe të vakancave që ka pasur institucioni gjatë këtij viti, kryesisht në njësinë e inspektorëve. Në zërin “Shpenzime operative” realizimi i

buxhetit për vitin 2023 është në masën 100% dhe në zërin “Transferta për individë” është më masën 60%, kjo për shkak të kursimeve që janë bërë për shkak të rimbursimit të shpenzimeve të celularëve për funksionarë që përfitojnë sipas VKM-së.

Sa i takon realizimit të investimeve, kjo ka qenë një nga momentet pak më të vështira për institucionin tonë, pasi investimet për vitin 2023 janë bërë për rikonstruksionin e godinës, ku institucioni do të zhvillonte aktivitetin. Rikonstruksioni i godinës kishte planifikuar një vlerë 67 milionë lekë për vitin 2023, që ishte një pjesë e përfundimit të punimeve të rikonstruksionit, kurse pjesa tjetër ishte për vitin 2024.

Problematikat që u hasën gjatë zbatimit të punimeve për rikonstruksionin e godinës ishin, sepse në momentin që filluan, u bë një pjesë e punimeve dhe pasi filluan me prishjen e suvasë dhe çmontimin e linjave elektrike, u konstatua se kishte disa probleme në strukturën konstruktive të godinës. Për këtë shkak punimet u pezulluan dhe rifilloi edhe një herë projekti i rishikimit të këtyre problematikave që dolën. Momentalisht jemi në fazën që projekti është parë, duke qenë se është një godinë e vjetër dhe është monument kulture. Procesi i rishikimit dhe i lejeve që merren për rikonstruksionin e kësaj godine është një proces që zgjat në kohë. Duke qenë se është një godinë e vjetër dhe për shkak të rëndësi që ka, ne jemi përpjekur të jemi seriozë dhe ta rishikojmë projektin, me qëllim që kjo godinë të ristrukturohet dhe të mos ketë më nevojë në vijim për rishikim dhe rikonstruksion.

Në këtë fazë që flasim, sa i takon investimit, ajo është në ritme të ulëta, por deri në fund të vitit mendojmë që të paktën të realizojmë pjesën më të madhe të planifikimit që ishte bërë për vitin 2023, duke shpresuar deri në 100% të fondit të parashikuar për vitin 2023.

Sa u përket kërkesave për zërat buxhetorë për vitin 2024, në total për institucionin është kërkuar një buxhet në vlerën 403,4 milionë lekë. Në projektligjin e paraqitur janë parashikuar 325, 8 milionë lekë. Ky zë buxheti ka një rritje në vlerën 27%. Në total ka një rritje 13%, por është një rritje 27% për sa u përket shpenzimeve korrente dhe ka një ulje 29% në investime.

Për shpenzimet korrente, rritja është për shkak të efektit që ka në buxhet rritja e pagave të inspektorëve magjistratë, por edhe i të gjithë stafit administrativ gjatë vitit 2023. Pra, kemi një diferencë në zërin e parashikuar në vlerën që ka kërkuar institucioni ynë për vitin 2024 me vlerën e parashikuar në projektbuxhet. Më në detaje: janë parashikuar 273,8 milionë lekë nga 298,5 milionë lekë në shpenzime korrente; në investime janë parashikuar 52 milionë lekë nga 104,9 milionë lekë të kërkuara nga ne në PBA-në 2024-2026; në zërin “Paga dhe sigurime” janë 12,9 milionë lekë më pak të parashikuara nga fondi i kërkuar. Sigurisht, për zërin “Paga dhe sigurime” e kuptojmë që në projektbuxhet është pasur parasysh realizimi

për vitin 2023, por ky realizim në nivele më të ulëta (në 70%) ka ardhur për shkak të vakancave. Kështu që, në vitin 2024 mendojmë që zëri duhet të jetë i plotë, sepse plotësimi i vakancave është një mundësi, kryesisht në njësinë e inspektorëve, dhe mendojmë që mund të realizohet 100%, ndaj edhe fondi i pagave duhet të rishihet me këtë shtesën 12,9 milionë lekë.

Transfertat korrente

Kemi kërkuar një vlerë prej 595 mijë lekësh, që është për shkak të kuotës vjetore që duhet të paguajë Inspektori i Lartë të Drejtësisë, sepse është bërë anëtar me të drejta të plota në Asamblenë e Përgjithshme të RESIJ-it (Rrjeti European i Shërbimeve të Inspektimit), një rrjet i BE-së, në të cilin gjatë vitit 2023 Inspektori i Lartë të Drejtësisë u bë anëtarë me të drejta të plota. Kjo është një kuotë, të cilën, për shkak të anëtarësimit dhe për shkak të statutit që parashikon asambleja, ne duhet ta paguajmë në vlerën e 5 mijë eurove.

Në zërin “Shpenzime operative” kemi kërkuar 35 milionë lekë, por që janë vënë në dispozicion 23 milionë e 770, pra është një diferencë prej 11 mijë e 190. Ky është një zë shumë i rëndësishëm, sepse të gjitha aktivitetet dhe masat në zbatim të objektivave strategjike mbahen nga ky zë dhe mendojmë që me këtë ndryshim që kemi mund të cenohet sadopak realizimi dhe performanca e institucionit.

Në zërin “Investime” nevojat e institucionit janë 104,900 milionë lekë, por janë vënë në dispozicion 52 milionë lekë, pra diferenca është 52 milionë lekë. Mosrakordimi midis kërkesave dhe projektbuxhetit vjen, sepse përshtatja e zyrave të godinës kërkonte 62,6 milionë lekë. Ky zë është kërkuar në këtë masë, sepse është rishikuar projekti dhe janë shtuar zërat e punimeve. Zërat e punimeve arritën deri në 20% të vlerës së kontratës, megjithatë diferenca është 12,6 milionë lekë, që është më pak se 20%, por, nëse nuk do të vihet në dispozicion shtesa që kërkohet nga rishikimi i projektit, kjo mund të vërë në dyshim realizimin e projektit për rikonstruksionin.

Zëri i dytë janë “pajisjet”. Ne parashikojmë që në prill të vitit 2024 do të përfundojë rikonstruksioni i godinës dhe, nëse përfundon, sigurisht që duhet të pajiset edhe me pajisje nëpër zyra, që mendojmë që mobilimi i zyrave funksionale për të gjitha strukturat e institucionit shkon në vlerën 22,3 milionë lekë.

Po ashtu është edhe një zë tjetër, që nuk është parashikuar, ku ne kemi kërkuar një zë për blerje automjeteve 15 milionë lekë. Deri tani institucioni i ka realizuar kërkesat për transport dhe lëvizje nëpërmjet kontratave me qira të automjeteve, është bërë një analizë dhe kemi arritur në konkluzionin që është më ekonomike blerja e makinave, kryesisht në funksion të njësisë së inspektorëve.

Një nga detyrat kryesore që ka institucioni është kryerja e inspektimeve. Duke qenë se në 3-vjeçarin e parë të institucionit fokus kryesor ishte shqyrtimi i ankesave, me përfundimin e *backlog*-ut në fund të vitit 2023 fokus kryesor janë inspektimet jo vetëm në zbatim të ligjit, por dhe në zbatim të rezolutës, të dokumenteve ndërkombëtare, për të cilat ne kontribuojmë në zbatim të strategjisë ndërsektoriale. Por inspektimet pa pasur mjete transporti do të dështojnë, pra nuk do të realizohen. Kështu që, ne mendojmë se të gjitha këto zëra që kemi kërkuar janë zëra funksionale, domethënë e ndihmojnë institucionin që të arrijë të zbatojë detyrat funksionale dhe objektivat strategjike që ka.

Këto janë në mënyrë të përmbledhur.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Pasko!

Fjalën e ka zoti Xhoxhi.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit, kryetare!

Edhe një herë kolegë, për sa i përket projektbuxhetit për vitin 2024 të ILD-së, kemi një parashikim prej rreth 325, 8 milionë lekë, nga të cilat 248,8 milionë lekë shpenzime do të jenë për pagat dhe sigurimet shoqërore; 24 milionë lekë shpenzime do të jenë për mallra dhe shërbime dhe 52 milionë lekë shpenzime do të jenë për investime.

Numri i punonjësve për vitin 2024 për Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë është parashikuar të jetë 101 punonjës. Edhe për ILD-në, ashtu si edhe për institucione të tjera që diskutuam pak më parë, në projektbuxhetin e vitit 2024 në krahasim me buxhetin e vitit 2023 kemi një rritje prej 37,4 milionë lekësh ose 13% më shumë, nga të cilat: 58,4 milionë lekë ose 27% më shumë do të jenë për shpenzime korrente; 21 milionë lekë ose 29% më pak shpenzime do të jenë për investime, pra edhe këtu kemi ulje të shpenzimeve të investimeve, ndërsa numri i punonjësve do të mbetet i njëjtë me një viti më parë.

Referuar të dhënave të realizimit të buxhetit për 9-mujorin e vitit 2023 buxheti është karakterizuar në masën 50%. nga të cilat shpenzimet korrente në masën 64% dhe shpenzime për investime vetëm në masën 7%.

Përfaqësuesja e ILD-së i theksoi kërkesat që ka bërë pranë Ministrisë së Financave dhe Kuvendit në projektligjin e paraqitur në Këshillin e Ministrave në një vlerë prej 77,6 milionë lekësh, nga ku: 12,9 milionë lekë janë shpenzime për paga, pra për të përballuar kostot financiare; 595 janë shpenzime në zërin e transferimeve korrente, pra për angazhimet në organizatat ndërkombëtare të Këshillit Europian për të shërbimit të inspektimit dhe 11,2 milionë lekë janë shpenzime për mallra dhe shërbime për sigurimin e logjistikës së nevojshme të institucionit.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar edhe një shtesë prej 52,9 milionë lekësh në zërin e investimeve dhe këtu i ka të ndara në 12,6 milionë lekë për mbulimin e kostove shtesë të punimeve, sipas preventivit të projektit të rishikuar të rikonstruksionit të godinës; 22,3 milionë lekë shtesë në zërin e investimeve për mobilim zyrash pas rikonstruksionit; 3 milionë lekë shtesë në zërin e investimeve për sigurimin e pajisjeve të dhomës së serverëve pas rikonstruksionit dhe 15 milionë lekë shtesë në zërin e investimeve për blerjen e dy automjeteve shtesë në dispozicion të inspektorëve.

Përfaqësuesja e ILD-së i sqaroi me detaje në kërkesat e saj qoftë në zërin e shpenzimeve, por edhe në atë të investimeve. Unë, në fakt, do të doja vetëm një sqarim për zërin e investimeve për mobilim zyrash pas rikonstruksionit. A ka institucioni momentalisht mobilje zyrash apo nuk ka, që kërkon një fond për blerje mobilje zyrash të tjera?

Këta kolegë, bashkë me Ministrinë e Financave dhe me sugjerimet tuaja në komision, ne duhet t'i rishikojmë kërkesat e paraqitura nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë dhe të vendosim më pas për to.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Zonja Çausholli, a jeni në linjë, na ndiqni?

Vilma Çausholli – A më dëgjoni?

Klotilda Bushka – Po.

Fjala është për ju për Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë për çfarë dëgjuat deri tani.

Vilma Çausholli – Faleminderit, zonja kryetare!

Në lidhje me inspektoratin e Lartë të Drejtësisë ajo që do të dëshiroja ta ndaja me ju është rivlerësimi edhe një herë i kërkesave shtesë të institucionit, sidomos në zërin e investimeve, duke na kujtuar qartë edhe pozicionin në të cilin vendoset Ministria e Financave në planifikimin dhe në kërkesat për investime. Nëse do të shikojmë një analizë për zërin e investimeve, gjë që u ngrit edhe më herët lidhur me çështjen e ndërtimeve apo rikonstruksioneve për institucionin e ILD-së, konstatojmë se ndër vite janë dhënë shpenzime për investime në një masë të konsiderueshme ose në mbështetje të atyre që ka kërkuar vetë institucioni.

Nga viti 2021 ne kemi një planifikim të shpenzimeve buxhetore në masën 52 milionë lekë me një realizim prej 14 milionë lekësh, duke vijuar në vitin 2022 me një planifikim prej 64 milionë lekë të investimeve me një realizim prej 15 milionë lekësh dhe, në përfundim, në buxhetin e vitit 2023, kur u planifikuan 73 milionë lekë dhe janë realizuar vetëm 4,9 milionë lekë për arsye objektive apo për arsye të ndryshme. Kjo na ka vendosur në një pozicion të

vështirë për planifikimin e mëtejshëm të këtyre investimeve, sepse ne ecim me rendin e planifikimeve në afate buxhetore 3-vjeçare dhe në vitin 2023 ne kemi parashikuar dhe nëse do të realizohet fondi prej 73 milionë lekësh të investimeve të akorduara do të vijohet më pas me mobilimin dhe me të gjitha kërkesat e tjera që, sigurisht, do të vijnë në rënie. Tashmë kemi një kthim mbrapa të këtij problemi, sepse investimi nuk është realizuar dhe do të duhet që të rishikohet edhe një herë projektbuxheti i vitit 2024, që ishte parashikuar dhe është programuar nga ana jonë në masën 52 milionë lekë.

Unë gjykoj të rishikohen edhe një herë në mënyrë të saktë nga të gjitha institucionet këto kërkesa shtesë në investime, sepse marrja e fondit dhe mosrealizimi i fondit na çon në mospërdorim me efektivitet të fondeve buxhetore, sepse ky fond i hiqet një objekti apo një problematike tjetër në një ministri apo në një institucion tjetër, duke u dhënë tek institucionet e sistemit të drejtësisë dhe, në fakt, nuk realizohen prej tyre.

E njëjta situatë është edhe te KLGJ-ja, nëse do të merreshim me projektet dhe me rikonstruktionet e godinave të gjykatave, por nuk dua të futem në detaje, sepse, siç e thashë, mund të ketë edhe arsye objektive që realizimi nga 73 është në 5 milionë lekë. Pra, është tepër e vështirë që ne t'i parashikojmë këto raste objektive dhe t'i përfshijmë në projektbuxhetet përkase të viteve në vijim, sepse kemi një programim 3-vjeçar, që duhet ta respektojmë në tavanet buxhetore që janë miratuar më herët edhe në ligjin e buxhetit të vitit 2023, pasi jepen në trend 3-vjeçar.

Për shpenzimeve të tjera në lidhje me pagat, unë jam plotësisht e bindur se fondi i akorduar nga Ministria e Financave me një rritje prej 60 milionë lekësh do të jetë mëse i mjaftueshëm për të përballuar të gjitha shpenzimet e këtij institucioni. Ndërkohë, në lidhje me shpenzimet për kuotën e organizmave ndërkombëtare unë vlerësoj se duhet marrë në konsideratë dhe nga ana jonë do të shikohet mundësia e sistemimit të një fondi prej 5 mijë euro, që është i domosdoshëm për shkak të anëtarësimit të këtij institucioni.

Për sa u përket shpenzimeve të tjera mendoj se janë të vijueshme edhe në vitin 2023 dhe mund ta përballojnë lehtësisht veprimtarinë kryesore të institucionit.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Çausholli!

A ka pyetje? Nuk ka.

Unë kam një diskutim.

Zonja Pasko, unë do të doja që ju të ndiqnit këshillat e zonjës Çausholli, sepse kur vjen puna te çështjet buxhetore, të gjithë ne jemi të ndjeshëm dhe vëmë në balancë ushtrimin

e përgjegjësiwe funksionale të institucionit me atë që quhet parimi i prioritizimit të nevojave dhe mundësiwe buxhetore. Kështu që mua më duket racionale çfarë sugjeron zonja Çausholli.

Gjithsesi, deri sa ne të bëhemi gati për shqyrtimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit, ju keni mundësi të rakordoheni. Unë po jua them paraprakisht që ne kemi punuar me Ministrinë e Financave për buxhetin dhe kemi kuptuar se ato që janë adresuar për buxhetin e vitit 2024, me disa çështje të vogla, janë të logjikshme dhe janë të drejta. Gjithsesi, për këto çështje ne realizojmë këto dëgjesa, kuptojmë nevojat tuaja dhe kërkojmë mirëkuptimin e të gjithëve, sepse, ashtu siç me të drejtë e tha edhe zonja Çausholli, nëse jepet një zë për një investim dhe nuk realizohet, ky investim merret diku tjetër dhe kemi mungesë në dy projekte dhe jo vetëm në një, pavarësisht se ne nuk paragjykojmë. Pa diskutim, mund të ketë arsye objektive, por edhe ne duhet të ecim pak me më shumë ekonomizim, aq më tepër në kohët që po kalojmë, që nuk është e lehtë, të them të drejtën, të përballohen pasojat e krizës që vijnë nga lufta në Ukrainë apo pasojat e krizës energjetike. Ne këto i kemi kaluar, i kemi përballuar, por duhet që të gjithë t'i kemi në konsideratë kur merremi me projektligjin e buxhetit.

Unë ju falënderoj, zonja Pasko!

Falënderoj edhe relatorët e Ministrisë së Financave, të cilët, bashkë me institucionin tuaj, duhet të rakordojnë edhe një herë këto që diskutuam këtu dhe më pas do të shqyrtohen nga komisioni në mbledhjen e tij përkatëse.

Zonja Pasko, faleminderit!

Jeni e lirë të shkoni dhe punë të mbarë.

Dëshira Pasko – Faleminderit edhe juve për dëgjësën!

Klotilda Bushka – I urojmë punë të mbarë edhe zonjës Koka!

Vijojmë me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

A është në linjë zoti Sokol Çomo? Po, është.

Atëherë, do të vijojmë me zotin Sokol Çomo, kryetar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili është në linjë së bashku edhe me zonjën Laerta Rooze, sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Më pas fjalën do ta marrë zoti Edmond Verçani, sekretar i Përgjithshëm i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili, gjithashtu, shoqërohet nga zoti Agim Paskali, drejtor Ekonomik dhe i Shërbimeve Mbështetëse dhe zonja Albana Pulaj, drejtoreshë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Publikun.

Fillimisht fjala është për ju zoti Çomo dhe më pas do ta marrin fjalën relatorët dhe përfaqësuesja e Ministrisë së Financave.

Teknika të mundësojë fjalën për zotin Çomo.

Zoti Çomo, ju lutem, të dilni edhe me figurë.

Sokol Çomo – Përshëndetje!

Nuk e di nëse dëgjohem?

Klotilda Bushka – Po, ju dëgjojmë.

Sokol Çomo – Përshëndetje, e nderuar kryetare!

Përshëndetje, të nderuar anëtarë të komisionit!

Përshëndetje përfaqësues të Ministrisë së Financave!

Në mënyrë të përmbledhur unë do të ndalem në disa momente kryesore që kanë të bëjnë me projektbuxhetin e viti 2024.

Së pari, dua të ndalem në faktin se Kolegji i Posaçëm i Apelit ka një parashikim të posaçëm në ligjin e tij organik, ku në nenin 18 të tij thuhet: “Struktura organizative dhe klasifikimi i pagave për personelin e institucioneve të rivlerësimit miratohet nga Kuvendi me propozimin e institucionit përkatës”.

Në këtë kuadër, në vitin 2023, KPA-ja i është drejtuar me një kërkesë Kuvendit të Shqipërisë, konkretisht me shkresën nr. 803 protokoli, datë 05.07.2023, në të cilën ka kërkuar disa ndryshime në vendimin përkatës të Kuvendit, që rregullon strukturën dhe organikën e Kolegjit. Në të njëjtën kohë ne kemi kërkuar në muajin tetor, konkretisht nëpërmjet një shkrese zyrtare drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, që çështjet, të cilat kanë të bëjnë me strukturën organizative të Kolegjit, mundësisht të trajtoheshin nga Kuvendi përpara miratimit të projektbuxhetit, sepse, në mënyrë të padiskutueshme, ato ndikojnë në mënyrën e parashikimit të fondeve buxhetore nga Ministria e Financave. Sot jemi përballë faktit që, në kushtet kur kërkesa jonë për ndryshim të strukturës dhe klasifikim të pagave nuk ka qenë e mundur të shqyrtohet deri në këto momente, edhe projektbuxheti që juve ju është paraqitur nga Ministria e Financave është në raport me vendimet e mëparshme të Kuvendit. Do të flas shumë shkurt pse ka qenë e nevojshme të rishikoheshin vendimet e Kuvendit.

Vendimet e Kuvendit, që kanë rregulluar deri më sot strukturën dhe klasifikimin e pagave, konkretisht është vendimi me nr.92/2017, që është ndryshuar me vendimin nr.35/2022 të Kuvendit të Shqipërisë “Për klasifikimin e pagave” janë vendime të bazuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.187, të datës 08.03.2017, por zhvillimi i ri që ka sjellë domosdoshmërinë e rishikimit nga Kuvendi të klasifikimit të pagave për Kolegjin e Posaçëm të Apelit është ndikuar nga miratimi i vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave, që parashikoi një klasifikim të ri të pagave.

Në kushtet kur ky vendim i Këshillit të Ministrave u kërkonte institucioneve të përshtatnin klasat e pagave kjo gjë është bërë nga KPA-ja pas hyrjes në fuqi të këtij vendim, por, për shkak të specifikës, siç e theksova, që është Kuvendi i Shqipërisë ai që miraton strukturën organizative dhe klasifikimin e pagave për KPA-në dhe për institucionet e tjera të rivlerësimit, ne kemi vlerësuar paraprakisht se ka qenë e nevojshme të bëhej një përshtatje e vendimeve aktuale të Kuvendit me parashikimet e vendimit të ri të Këshillit të Ministrave për klasifikimin e pagave dhe në këtë mënyrë të përputhet klasifikimi aktual, që është duke u zbatuar, me atë që duhet të parashikojë vendimmarrja përkatëse e Kuvendit.

U zgjata pak për të sjellë në vëmendje se sot do të ndalemi jo vetëm në trajtimin e kërkesave buxhetore, por për të kuptuar pse kërkesat buxhetore kanë qenë të lidhura edhe në raport me kërkesat që kemi pasur për ndryshime në strukturë, ndryshime, që nuk është se janë të një shkalle shumë të madhe dhe kërkojnë modifikime shumë thelbësore, por, konkretisht, kanë të bëjnë me një kërkesë për të pasur një klasifikim të disa prej pozicioneve kyçe mbështetëse të administratës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Në të njëjtën kohë, për 6 punonjës, të cilët prej disa vitesh punojnë në Kolegj me kohë të përkohshme ose me 6 orësh (nëpërmjet skemës së miratimit që bëhet çdo vit nga Këshilli i Ministrave), është kërkuar që të konvertohen dhe të kthehen në punonjës me kohë të plotë, në mënyrë që të ndihen pjesë përbërëse e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sikurse *de facto* janë prej disa vjetësh.

Një moment tjetër i rëndësishëm për t'u sjellë në vëmendje është edhe efekti prapaveprues i vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me pagat e magjistratëve. Sjell në vëmendje se Kolegji i Posaçëm i Apelit ka hyrë në vitin e 7 të veprimtarisë së tij, pra i jemi larguar pikës së fillimit dhe po i afrohem relativisht me shpejtësi pikës së përfundimit të procesit. Kushtetutëbërësi ka planifikuar që në mesin e vitit 2026 Kolegji i Posaçëm i Apelit do ta ndërpresë veprimtarinë, duke ia kaluar stafetën Gjykatës Kushtetuese për të gjitha problematikat që do të trajtohen nga kjo gjykatë.

Kolegji i Posaçëm i Apelit gjatë këtij 9-vjeçari, përveç procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ka një detyrë funksionale që, në fakt, është detyrë e Gjykatës Kushtetuese sipas Kushtetutës, pra qenia si gjykatë disiplinore. Çfarë do të thotë?! Aktualisht në Kolegjin e Posaçëm të Apelit shqyrtohen të gjitha ankimet e gjyqtarëve e prokurorëve kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në të njëjtën kohë Kolegji i Posaçëm i Apelit gjatë mandatit 9-vjeçar do të jetë edhe gjykata që do të shqyrtojë proceset disiplinore ndaj anëtarëve të institucioneve qeverisëse në sistemin e drejtësisë. Çfarë do të thotë? Nëse në teori do të ketë një proces

disiplinor për një anëtar të Këshillit Gjyqësor apo të Këshillit të Lartë të Prokurorisë apo i të gjithë asaj liste me zyrtarë të lartë në sistemin e drejtësisë, Kolegji i Posaçëm i Apelit do të funksionojë si gjykatë disiplinore. Këto detyra natyrshëm që do t'i kalojnë Gjykatës Kushtetuese. Për këtë arsye Kolegji i Posaçëm i Apelit është parashikuar që në këtë moment të funksionojë si një dhomë e dytë e Gjykatës Kushtetuese dhe në momentin fundor Gjykata Kushtetuese do të merret me çështjet e procesit disiplinor.

Për t'iu kthyer problemeve buxhetore, kur Kolegji ka bërë kërkesat e veta buxhetore, ka pasur në konsideratë edhe kërkesat për ndryshim në strukturë dhe në klasifikimin e pagave. Konkretisht, kërkesa për ndryshimin e klasifikimit të pagave, së pari, lidhet me pozicionin e drejtorit të drejtorisë. Në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë dy drejtori: njëra drejtori merret me menaxhimin e çështjeve gjyqësore dhe tjetra është Drejtorja Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse. Pra, bëhet fjalë për dy drejtorë.

Në kushtet kur volumi i punës nga viti në vit ka ardhur duke u shtuar, në kushtet kur Drejtorja e Menaxhimit të Çështjeve ka një rol kyç dhe në të njëjtën kohë kur drejtorja mbështetëse, që është edhe drejtori ekonomike, përballet me një volum të shtuar, kemi propozuar që, përveç situatës aktuale që kemi me përshtatjen që kemi bërë, sipas vendimit nr. 325, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave të kategorisë e drejtorëve nga klasa "II-1" të kalohet në klasën "I-4". Ku e kemi bazuar këtë kërkesë?! Sikurse e theksova, Kolegji është dhoma e dytë e Gjykatës Kushtetuese, por nga pikëpamja e trajtimit financiar, administrata e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me administratën e Gjykatës Kushtetuese. Ne gjithmonë kemi pasur një diferencë, e cila, me kalimin e viteve, për disa pozicione ka ardhur duke u ngushtuar, ndërsa për disa pozicione vazhdon të jetë evidente.

Sjell në vëmendje se në parashikimet ligjore të Gjykatës Kushtetuese thuhet se trajtimi financiar i administratës së kësaj gjykate shkon ekuivalent me trajtimin e administratës së Kuvendit të Shqipërisë. Pra, vetë Gjykata Kushtetuese, në dijeninë tonë, është në proces të tentativës për të pasur një klasifikim të ri të pagave për këto pozicione ekuivalente. Ne nuk kemi kërkuar që pagat të jenë sa pagat e strukturës homologe të Kuvendit, por të paktën të kalojmë në klasën "I-4", e cila është më e vlerësuar se klasa "II-1", që kemi aktualisht për dy drejtorët.

Në të njëjtën kohë kemi kërkuar një klasifikim të ri page për pozicionin e koordinatorit për mediet, marrëdhëniet me publikun dhe me jashtë. Sjell në vëmendje që Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk ka një drejtori që mbulon marrëdhënien me publikun dhe me mediet që në momentin kur është konceptuar. Edhe pse është kërkuar që në vitin 2017

që të kishte një drejtori të tillë, asnjëherë nuk është bërë e mundur krimi i një strukture të tillë. Ne nuk po kërkojmë në këtë moment krijimin e një strukture të tillë, por një klasifikim të ri page për një njeri të vetëm, i cili përballon të gjithë volumin e punës në marrëdhëniet me mediet, me publikun, me institucionet qendrore në kuadër të raportimit që Kolegji bën, qoftë dhe në kuadër të proceseve integruese të Shqipërisë, se nuk po marr shumë kohë duke ju listuar detyrat, pra nga klasa “III-1”, që e ka aktualisht, të kalohet në klasën “II-1”.

Pozicioni i fundit për të cilin kemi kërkuar një klasifikim të ri page, është pozicioni i sekretarit të kryetarit. Sjell në vëmendje që për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, ndoshta mund të jetë institucioni i vetëm ndër institucionet e reja të sistemit të drejtësisë, nuk është parashikuar kabinet për drejtuesin e institucionit. Nëse ju, që trajtoni dhe shikoni buxhetet, shikoni që shumë institucione kanë kabinete me numra që mund të kalojnë edhe dyshifrorin, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka vetëm një sekretar të kryetarit, i cili është njeriu që duhet ta asistojë atë në të gjithë proceset e punës që ka, për të thirrur dhe për të organizuar mbledhjen e gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili është organi më i lartë vendimmarrës në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Ne nuk kërkojmë rritje të numrit të kabinetit, por kërkojmë një klasifikim të ri page për sekretarin e kryetarit, pra nga 90 mijë lekë që është paga aktuale, të kalohet në klasën “II-1”. Ne kemi gjetur si pikë referimi këtë klasë, sepse aplikohet për këshilltarët e komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Pra, këshilltari i një komisioni në Këshillin e Lartë Gjyqësor sot paguhet më shumë sesa njeriu i vetëm që asiston kryetarin e Kolegjit të Posaçëm i Apelimit dhe mbledhjen e gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Pra, ne kërkojmë që të kalohet në një perceptim të ri të pozicionit, nga pozicioni i thjeshtë si sekretar, në pozicionin e këshillimit të mbledhjes së gjyqtarëve dhe deri diku plotëson nevojat e kryetarit të Kolegjit për kabinet.

Për sa i përket çështjes së konvertimit të punonjësve me kohë të pjesshme në punonjës me kohë të plotë, dua të them se puna e të gjithë këtyre punonjësve lidhet me shërbimet, që do të thotë 3 prej tyre i përkasin sekretarisë gjyqësore. Pra, me rritjen e volumit të punës së çështjeve, pa dyshim që sekretaria gjyqësore ka nevojë për burime njerëzore të shtuara në mbështetje të punës. Përsëri e ritheksoj, nuk bëhet fjalë për shtim numri, por vetëm për konvertim, pra nga punonjës me kohë të pjesshme në punonjës me kohë të plotë. Nuk po zgjatem më tej duke respektuar në maksimum kohën tuaj.

Për sa u përket problemeve buxhetore, ne kemi depozituar një material me shkrim, pasi kemi marrë një njoftim nga komisioni. Nëse ky material u është shpërndarë anëtarëve, nuk po i referohem për të kursyer kohën tuaj, se aty janë zbërthyer pretendimet dhe kërkesat tona me shifra.

Klotilda Bushka – E keni fjalën për materialin që ka ardhur sot, zoti Çomo?

Sokol Çomo – Po, është një material që është dërguar nëpërmjet *email*-it dje pasdite, meqenëse u njoftuam se deri në përfundim të ditës së djeshme mund ta depozitonim materialin.

Klotilda Bushka – Sot ka ardhur një material në protokoll, ndërkohë që sekretaria do ta skanojë dhe do t’ua kalojë të gjithë anëtarëve të komisionit.

Sokol Çomo – Faleminderit! Atëherë, meqenëse materiali do t’u vihet në dispozicion të anëtarëve të komisionit, për të kursyer kohë, po e them në mënyrë të koncentruar atë material.

Klotilda Bushka – Po, mund ta përmbliidhni shkurtimisht.

Sokol Çomo – Ne kemi sjellë në vëmendje se kërkesat tona kanë qenë për një buxhet rreth 336,4 milionë lekë, ndërkohë parashikimi i projektligjit që ju keni në shqyrtim, është në nivelin 243,9 milionë lekë, pra ka një diferencë të pambuluar me rreth 92,5 milionë lekë.

Zëri kryesor në të cilin konstatohet mungesa e mbulimit të kërkesës së Kolegjit, ka të bëjë me zërin e shpenzimeve të personelit, ku bëhet fjalë për mungesën e parashikimit në masën 78,4 milionë lekë.

Për sa u përket shpenzimeve operative, ka një planifikim më të ulët sesa kërkesa prej 1,5 milionë lekësh. Ndërsa për sa i përket zërit “investime” bëhet fjalë për një total prej 12,7 milionë lekësh. Pra ky është zëri i asaj mungese në raportin mes kërkesës së Kolegjit dhe parashikimit të bërë në projektbuxhet.

Dua të sjellë në vëmendje se edhe me strukturën aktuale që ne kemi me 57 punonjës, pra pa u bërë klasifikimi i ri i pagave dhe pa u konvertuar punonjësit me kohë të përkohshme në punonjës me kohë të plotë, përsëri planifikimi buxhetor ka një mosmbulim të shpenzimeve për personelin në masën 17,5 milionë lekë.

Për sa i përket trajtimit të pjesës së prapambetur, sipas efekteve të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, meqenëse Kolegji i Posaçëm i Apelimit e ka të shkurtër kohën e veprimtarisë, ne kemi kërkuar që të parashikohet mundësia e këtij rikuperimi në një kohë sa më të shpejtë të mundshme. Në dijeninë time, ky proces nuk lidhet vetëm me anëtarët e Kolegjit të Apelimit, se edhe gjyqtarët, edhe prokurorët e të tria niveleve janë duke u ballafaquar me të njëjtat kërkesa, edhe këshillat përkatëse janë duke trajtuar të njëjtat kërkesa, pra, për fat të keq, situata aktuale është e tillë që shumë gjyqtarë dhe prokurorë janë drejtuar gjykatave të zakonshme për të kërkuar përfitimin nga ky efekt i vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Në diskutimin që kemi pasur me kolegët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nuk do të ishte etike dhe as e përshtatshme që një gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm i Apelimit të

shkojë para një gjyqtari të Gjykatës Administrative, të cilin ose e ka vetuar, ose e ka në proces vetimi dhe të kërkojë që të zbatohet efekti prapaveprues që ka të bëjë me përfitimin në pagë të gjyqtarëve të Kolegjit, por edhe të këshilltarëve të Kolegjit, sepse edhe këshilltarët janë të lidhur për shkak të ligjit me efektin e pagës së gjyqtarit. Ndaj, në këtë kuadër, ne e ritheksojmë nevojën që kjo situatë të zgjidhet nëpërmjet një parashikimi buxhetor dhe të shmanget çdo formë tjetër e pakëndshme për trajtimin e kësaj çështje.

Në vija të përgjithshme, këto janë çështjet kryesore, e nderuar kryetare, që menduam se është momenti të trajtohen, pra për ndryshimin e strukturës, për klasifikimin e pagave dhe kërkesat për shqyrtimin e ligjit që ka të bëjë me projektbuxhetin.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Çomo!

Para se t'ua jap fjalën përfaqësuesve të institucionit tjetër, dua të bëj një sqarim. Në fakt, ju bëtë një relativitet për dy çështje: për çështjen buxhetore dhe për një kërkesë të re që keni sjellë për sa u takon disa ndryshimeve në strukturën organike të institucionit. Këto çështje janë të lidhura dhe e kuptojmë se, nëse nuk shqyrtohet njëra, nuk mund të sqarohen kërkesat për buxhetin, por, nga ana tjetër, ju kujtojmë se kjo kërkesë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për strukturën është pjesë e kalendarit të punimeve të komisionit dhe, për shkak se vjen në komision gjatë kohës kur është në shqyrtim edhe buxheti, do të shqyrtohen bashkërisht.

Në lidhje me kërkesën për ndryshime në strukturën organike, Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni i Ligjeve si komision përgjegjës, është i detyruar të marrë mendimin e Ministrisë së Financave dhe pa diskutim të Departamentit të Administratës Publike. Ajo që dua t'ju them, është se ju e keni sjellë këtë shkresë në korrik, por, në fakt, kërkesa për ndryshime në strukturën organike lidhet me pasojat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për riklasifikimin e pagave”. Ashtu si të gjitha institucionet u janë drejtuar komisioneve përgjegjëse në Kuvend për t'i përshtatur pagat e tyre me realitetin e ri të pagave, sipas ligjit përkatës dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325 të marsit 2023, ju keni bërë kërkesa edhe për strukturën organike. Në fakt, sipas rregullave, duhej që kërkesat për strukturën organike, pra për shtesa dhe për ndryshime, t'i kishit adresuar në fillim, qëkur keni nisur procesin e kërkesave për buxhetin e vitit 2024, në Ministrinë e Financave. Ndaj, edhe ne gjendemi sot para situatës kur duhet t'i trajtojmë të dyja çështjet së bashku dhe, kur t'i trajtojmë të dyja çështjet së bashku, duhet patjetër të kemi mendimin e Ministrisë së Financave. Kështu që do t'i trajtojmë bashkë. Me këtë rast ju e bëtë edhe prezantimin për strukturën, kështu që, kur të jetë kjo çështje, dhe do të jetë para se ne ta miratojmë buxhetin

nen për nen dhe në tërësi, e keni të ezauruar prezantimin e strukturës, sepse e morët të gjithë kohën e nevojshme për sqarime në detaje.

Duke thënë këtë, unë do t'ia jap fjalën përfaqësuesit të Komisionerëve të Kualifikimit, zotit Edmond Verçani, sekretar i Përgjithshëm. A është *online*? Po.

Diskutimi për të dyja institucionet do të bëhet në këtë mënyrë: në fillim do të bëhet prezantimi nga të dy relatorët, pastaj do të flasë Ministria e Financave, më pas kolegët për pyetje dhe diskutime.

Zoti Verçani, mirë se erdhët! Ndjesë që na keni pritur!

Fjala për ju.

Edmond Verçani – Përshëndetje, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dërguar një material brenda afateve në institucionin tuaj, në Komisionin e Ligjeve. Po ky material do të rishqyrtohet shkurtimisht nga ana ime dhe jemi të gatshëm për pyetje dhe për diskutime nga ju.

Për vitin 2023, ashtu siç e keni parë edhe në tabela, ne jemi në shifrën 84,4% dhe në fund të vitit do të shkojë 100%, sepse janë edhe dy muaj shpenzime, dhe ka kohë për këto shpenzime. Po t'i shikojmë me zëra, gjithmonë te fondi i pagave dhe i sigurimeve shoqërore kemi pasur komunikime të vazhdueshme me Ministrinë e Financave për të arritur në shifra, të cilat janë ndikuar edhe nga vendimet e fundit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me plotësimin e pagave të komisionerëve dhe të këshilltarëve, të cilat janë shpenzime korrente për periudhën 2018-2022. Megjithatë, po t'i krahasojmë shifrat që ka kërkuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për vitin 2024 me projektbuxhetin e Ministrisë së Financave po për vitin 2024, ne kemi një diferencë për 18 milionë e 510 mijë lekësh, ku 13 milionë e 700 janë paga dhe 4 milionë e 810 mijë janë sigurime shoqërore. Kjo tregon se, në lidhje me fondin e pagave kemi këtë problem: çfarë kemi kërkuar dhe çfarë na është dhënë nga Ministria e Financave, sepse në këtë fond page që është kërkuar, kemi parashikuar që edhe këshilltarët të marrin 3 paga vështirësi, të cilën ua jep edhe ligji.

Në lidhje me vitin 2024, një problem shumë i madh, që shikoj unë si sekretar i Përgjithshëm, sepse kam edhe një vit kohë për ta mbyllur institucionin, është diferenca pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, i cili vendos për llogaritjen e pagave të magjistratit bazuar në kategorinë e pagës së referuesit "1/b" dhe shtesën e pagës për diplomë 14 mijë lekë. Ne e kemi bërë shumë të saktë llogaritjen, i kemi dërguar vazhdimisht kërkesat tona për t'u njohur kjo diferencë dhe shpenzimi, i cili duhet detyrimisht, sepse jetëgjatësia e institucionit tonë është deri në fund të vitit 2024, arrin

shumën 155 milionë lekë. Kjo është diferenca, e cila duhet të shpërndahe te komisionerët dhe te këshilltarët për sa i përket vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Institucionet e tjera, që unë i dëgjova kanë kohë, sepse janë të përhershme, disa e kanë afatin më të gjatë. I vetmi institucion këtu me jetëgjatësinë më të shkurtër është KPK-ja. Ministria e Financave dhe institucionet e tjera, si Komisioni i Ligjeve dhe Komisioni i Ekonomisë, detyrimisht duhet të merren me këtë kërkesë dhe ta shikojnë me shumë seriozitet, sepse, në qoftë se kjo kërkesë do të miratohet, ta zëmë në vitin 2025, ata nuk janë më në punë dhe nuk arrijnë dot t'i marrin këto para.

Ashtu siç tha edhe zoti Çomo, edhe mendimi i komisionerëve nuk është që t'u drejtohen gjykatave për të arritur në situatën e marrjes së këtyre parave, por kam besim që qeveria bashkë me deputetët, sepse nga ju ka dalë ky komision, do të vendosin dhe duhet të marrin masa që kjo shumë prej 155 milionë lekësh të gjendet dhe të jepet brenda vitit 2024, sepse këtu ka këshilltarë që janë larguar, janë këshilltarët aktualë dhe komisionarët, dhe këto janë shumat e detajuara, të cilat ne i kemi kërkuar nëpërmjet këtij projektbuxheti.

Në lidhje me strukturën, ne nuk kemi bërë kërkesa për strukturën, sepse edhe një vit jemi dhe do ta bëjmë me këta punonjës që kemi, por kemi kërkuar shtesë vetëm për një punonjës me kohë të pjesshme, pra nga 8 veta që kemi pasur me kontratë në vitin 2023, kemi kërkuar një shtesë, pra 9 veta. Ky është një punonjës, i cili do të shërbejë për të bërë transportin, sepse tani, me mbylljen institucionit, kemi shumë dosje, kemi shumë lëvizje inventarësh, të cilat nuk arrijmë dot t'i bëjmë me një punonjës. Realisht duhej ta kishim bërë kërkesën për 8 orë për të dy këta punonjës, por menduam që për 6 orë mund t'i mbyllim brenda ditës. Kështu që ajo që kemi kërkuar për vitin 2024 është një punonjës me kontratë.

Në lidhje me shpenzimet operative, në lidhje me investimet, ne nuk kemi asnjë kërkesë shtesë. Edhe pjesën që ne do ta çojmë deri në fund të vitit 2023, nuk besoj se do të shkojmë te limiti i fondit të planifikuar. Ne duhet të përshtatemi në bazë të regjistrit të prokurimeve dhe të bëjmë një planifikim të saktë dhe kaq. E vetmja kërkesë që kemi ne, dhe unë jam shumë i interesuar, është të zgjidhim problemin e diferencës së pagës si rrjedhojë e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, për vetë faktin që komisionerët edhe një vit punë kanë dhe nuk kanë mundësi që të ndjekin gjyqe në vitin 2025 apo në vitin 2026, të tjerët mund të kenë kohë. Pra, institucionet e tjera kanë kohë, ndoshta janë të përhershme apo kanë edhe 2-3 vjet kohë, por këta nuk kanë fare kohë. Kjo është arsyeja pse dola të flasë sot këtu, sepse e shikoj që për moshën dhe eksperiencën që kam, në krahasim me të gjithë komisionerët, jam i detyruar ta kërkoj, ndoshta në këtë lloj forme, sepse është shumë e rëndësishme për ne. Ne ndihemi keq kur dalim në takime, kur

bëjmë mbledhje, sepse na duket sikur nuk arrijmë dot të bëjmë kërkesa reale, por realisht e ndiejmë këtë detyrim që t'jua kërkojmë edhe juve si komision, edhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave, edhe deputetëve që janë aty.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Verçani!

Fjalën do t'ua jap relatorëve.

Zoti Xhoxhi, a do të flisni ju?

Fjalën e ka zoti Xhoxhi dhe më pas zonja Çausholli. Do të bëj edhe unë disa pyetje dhe komente për ato që prezantuan deri tani zoti Çomo dhe zoti Verçani.

Teknika, fjalën për zotin Xhoxhi.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit edhe ju, përfaqësues të Komisionit të Posaçëm të Apelimit dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për të gjithë prezantimin që bëtë për projektbuxhetin dhe për kërkesat e institucioneve respektive!

Po të shikosh projektbuxhetin e vitit 2024, të dyja institucionet kanë rritje në fondet e buxhetit, por po ndalem te Komisioni i Posaçëm i Apelimit, ku buxheti i parashikuar për vitin 2024 është rreth 243,9 milionë lekë, nga të cilat 218,9 milionë lekë janë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, 23,64 milionë lekë janë shpenzime për mallra dhe shërbime dhe 2 milionë lekë janë shpenzime për investime, ndërkohë numri i punonjësve për vitin 2024 është parashikuar të jetë 57.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2023, për Komisionin e Posaçëm të Apelimit kemi një rritje 36,5 milionë lekësh, ose rreth 17,6%, dhe e gjitha kjo rritje është reflektuar në zërin e shpenzimeve për paga. Po t'u referohemi të dhënave të realizimit të buxhetit për 9-mujorin e parë të vitit 2023, konstatojmë se ky buxhet është realizuar në masën 79%, nga të cilat shpenzime për pagat në masën 86%, shpenzime për mallra dhe shërbime në masën 27% dhe shpenzime për investime në masën 45%.

Komisioni i Posaçëm i Apelimit, ashtu sikurse përmendi edhe zoti Çomo, ka bërë kërkesa për fonde shtesë në projektbuxhetin vitit e 2024 në vlerën 92,7 milionë lekë, ku **vetëm 73,5 milionë lekë janë për zërin e shpenzimeve për paga dhe 5... në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime**, të cilat duhen për veprimtarinë normale të institucionit dhe 12,7 milionë lekë janë shtesë për blerjen e skanerit për kontrollin dhe urën e metalit. Në fakt, kjo është një kërkesë e përsëritur e institucionit.

Më lejoni, kolegë, që t'ju sjell në vëmendje që në buxhetin e vitit 2023, pra vjet, Komisionit të Posaçëm i Apelimit, në bazë të kërkesës së tyre, ne i kemi akorduar, i kemi

dhënë për punonjësit tri paga për vështirësi në vit, por edhe 10% vështirësi për pjesën e administratës. Gjithashtu, i kemi akorduar 8 punonjës me kontratë.

Më pas, po të ndalojmë te Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, buxheti për vitin 2024 është rreth 324 milionë lekë, nga të cilat 288 milionë lekë janë shpenzime për pagat dhe sigurimet shoqërore, 34 milionë lekë janë shpenzime për mallra dhe shërbime dhe 2 milionë lekë janë shpenzime për investime. Numri i punonjësve të parashikuar për vitin 2024 për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit është 76 punonjës.

Po ta krahasojmë buxhetin e vitit 2023 me projektbuxhetin e vitit 2024, rezulton se shpenzimet totale të Komisionit të Pavarur Kualifikimit janë rritur me rreth 48 milionë lekë, ose 17,5% më shumë, dhe e gjithë rritja është e fokusuar në zërin e shpenzimeve korrente. Ndërsa shpenzimet për investimet nuk kanë ndryshuar, gjithashtu edhe numri i punonjësve nuk ka ndryshuar.

Referuar realizimit të buxhetit në 9-mujorin e parë të vitit 2023, konstatojmë se shpenzimet korrente janë realizuar në masën 79%, ndërsa shpenzimet për investimet nuk janë realizuar.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ashtu si kundër e përmendi edhe përfaqësuesi i institucionit, ka paraqitur kërkesë për ndryshime buxhetore, për shtesë fondi, në vlerën 173,51 milionë lekë dhe këto kryesisht për mbulimin e shpenzimeve për paga të personelit, për vështirësitë e këshilltarëve dhe në përballimin e shpenzimeve korrente, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Ashtu siç e përmendi edhe përfaqësuesi i institucionit, kërkesa është edhe për shtimin e një punonjësi, pra 8 punonjës me kontratë, të bëhen 9 punonjës me kohë të pjesshme.

Pak a shumë, kjo ishte panorama e projektbuxhetit për të dyja institucionet. Kolegë, unë ju ftoj që pas diskutimeve dhe pas dëgjësës me Ministrinë e Financave, të reflektohet për kërkesat e të dyja institucioneve.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Zonja Çausholli, a më dëgjoni?

Vilma Çausholli – Po, zonja kryetare.

Klotilda Bushka – Fjala për ju, për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

Vilma Çausholli – Të dyja institucionet në buxhetin e...

Klotilda Bushka - Zonja Vilma, është ndërprerë lidhja.

Vilma Çausholli- Më dëgjoni?

Klotilda Bushka- Po, ju dëgjojmë.

Vilma Çausholli- Për të dyja institucionet shifrat në rritje të buxhetit janë pothuajse të përafërta, edhe KPA-ja, edhe Komisioni i Kualifikimit janë të dyja me një rritje në total të buxhetit prej rreth 18%, ndërkohë që për pagat dhe sigurimet shoqërore të dyja kanë një rritje prej 20%.

Dëgjova me kujdes lidhur me shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore, qoftë për KPA-në, qoftë për KPK-në. Nëse kemi diferenca të vogla, që lidhen me statusin aktual të strukturave të këtyre institucioneve, unë do të vlerësoja që të bëjmë edhe një herë një rakordim, sepse diferenca në vlera është minimaliste dhe mund të shqyrtohet dhe të vlerësohet nga ana jonë.

Lidhur me punonjësit e kontraktuar me kohë të pjesshme, kemi qenë gjithmonë të hapur dhe kemi mbështetur gjithmonë numrin e punonjësve në rritje të këtyre institucioneve dhe jemi të gatshëm që edhe për vitin që vjen këta punonjës të plotësohen. Miratimi i punonjësve me kontratë nuk bëhet në këtë moment, por do të bëhet nëpërmjet akteve nënligjore në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave.

Dua të sqaroj dhe sugjeroj se shpenzimet e personelit për punonjës të kontraktuar nuk janë pjesë e shpenzimeve të personelit që planifikojmë në këtë zë, sepse ato përballohen nga fondi i shpenzimeve korrente. Pra, duhet ta “zhveshim” strukturën aktuale të miratuar në vlerë me punonjësit e kontraktuar me kohë të pjesshme, të cilët do të kalojnë si fond të shpenzimit operative të institucionit. Gjithsesi, nëse ka diferenca midis shpenzimeve të planifikuara nga ana jonë dhe të përlogaritura nga të dyja institucionet, jemi të gatshëm për të rivlerësuar edhe një herë dhe për të saktësuar të dhënat.

Faleminderit!

Klotilda Bushka- Faleminderit, zonja Çausholli!

Kolegë, a ka ndonjë diskutim apo pyetje? Jo, nuk ka.

Unë kam një diskutim për ta përmbledhur të gjithë këtë dëgjese me institucionet e vetingut, sepse publiku kështu i njeh, pavarësisht se ne duhet t'i referojmë me emrat e tyre zyrtarë.

Bëhet fjalë për dy organet e vetingut: të shkallës së parë dhe atë të apelit, i cili është dhomë e Gjykatës Kushtetuese, të cilët paraqesin nevojat buxhetore, ku Kolegji i Apelit paraqet edhe disa nevoja për ndryshime strukturore.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit së shpejti e përfundon afatin e vet dhe paraqet këtu vetëm një shqetësim në lidhje me pagat e prapambetura për efekt të zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Kolegji i Posaçëm i Apelit ka, gjithashtu, të njëjtin shqetësim, por,

nga ana tjetër, paraqet edhe një strukturë të re të riorganizuar. Edhe ky organ do të ketë një afat të kufizuar, nuk mbaron vitin tjetër, por do të mbarojë brenda një periudhe të shkurtër kohore.

Në lidhje me pagat e prapambetura, që vijnë si detyrim i zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, për të qenë e saktë, jo pagat, por pagesat e prapambetura, mund t'ju sqaroj se kjo është një çështje që është diskutuar zyrtarisht, menjëherë sapo ka dalë vendimi i Gjykatës Kushtetuese, me përfaqësues të Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Drejtësisë, të Komisionit të Ligjeve dhe me institucionet e drejtësisë, përfshirë edhe organet e vetingut. Është vendosur të bëhet me faza. Në atë kohë, në fillim, duhej të bëhej rregullimi ligjor, pra, parashikimi me ligj i pagës së referencës së re të magjistratëve dhe më pas do të shihej edhe se si do të bëhej shlyerja e detyrimeve të prapambetura, si do të rezultonin ato e të tjerë, pra, të gjitha detajet që lidhen me këtë.

Po ju njoftoj që ky proces vijon dhe së shpejti do të kemi edhe një takim institucional të të gjithë aktorëve të përfshirë për gjetjen e një zgjidhjeje institucionale juridike. Besoj se kjo do ta ketë adresimin e saj së shpejti dhe në mënyrë të drejtë. Pra, nuk është shqetësim vetëm për ju, por është për të gjitha institucionet e tjera, të cilat e kanë ngritur dhe unë nuk u kam kthyer përgjigje në këto dëgjesa deri më sot, sepse doja të jepja një përgjigje për të gjitha institucionet. Pra, është një çështje në ndjekje, në vlerësim për të gjetur një zgjidhje institucionale juridike.

Sa i takon shtesave në strukturë që kërkohen, apo riorganizimit të strukturës, unë do t'i qëndroj edhe një herë argumentit tim se do të duhet patjetër të respektojmë mendimin e Ministrisë së Financave. Unë kam një tabelë të llogaritjes në vite të buxheteve dhe të kërkesave, dhënë veçanërisht Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ku ne kemi qenë gjithmonë në rritje dhe plotësim të kërkesave edhe sa u takon shtesave në personel, por edhe pagave. Mbaj mend që në një vit në ligjin e buxhetit kemi vënë edhe pagat për vështirësi si parashikim të posaçëm dhe kjo gjithmonë duke synuar që të mbështesim sa më shumë eficiencën e këtyre institucioneve. Pra, ne donim që të vijonte atëherë dhe të vijojë edhe sot me ritme të shpejta dhe të kënaqshme procesi i vetingut.

Veçanërisht tani në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit vijojmë të kemi statistika në kuadër të rritjes së numrave të shqyrtimit të çështjeve. Me sa shohim nga statistikat, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është pothuajse në përfundim dhe mendoj që brenda vitit 2024 i përmbyll detyrat që ka për sa i takon përfundimit të shqyrtimit të të gjitha subjekteve që ka në proces verifikimi.

Thënë këtë, unë dua ta mbyll duke i kërkuar Ministrisë së Financave, institucioneve të vetingut, që i dëgjuam sot dhe relatorëve, të rakordojnë shifrat, që i vijnë përshtat eficiencës së punës dhe nevojave të institucioneve, duke i vënë në balancë me mundësitë buxhetore të buxhetit të shtetit. Ndërkohë, ne do t'i shqyrtojmë të gjitha këto çështje kur të jemi te momenti i diskutimit dhe shqyrtimit nën për nën dhe në tërësi të buxhetit. Relatorët ta ndjekin këtë proces ashtu si me të gjitha institucionet e tjera.

Sokol Çomo- A mund të flas, zonja kryetare?

Klotilda Bushka- Po, zoti Çomo, patjetër!

Sokol Çomo- Lidhur me shqetësimin e përdorimit të fondeve të vitit, dua të sjell në vëmendje që jemi në proces të përdorimit të fondeve buxhetore, janë disa kontrata që Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka në proces negociimi dhe lidhjeje, të cilat do të lidhen brenda fundit të vitit, disa kontrata të tjera janë në zbatim, ku ne kemi marrë dhe do të marrim shërbime sipas tyre, ku do të ketë përsëri përdorim të fondeve buxhetore.

Dua të them që edhe ky vit, pra viti 2023, do të jetë plotësisht brenda tablosë së përgjithshme të shkallës së përdorimit të fondeve buxhetore që ka pasur Kolegji në të gjitha vitet e mëparshme. Pra, nuk do të kemi një situatë me përdorim fondesh në mënyrë më të limituara.

Për sa i përket rritjes së fondit për shpenzimet e personelit, sjell në vëmendje që vendimi i Gjykatës Kushtetuese solli një impakt të drejtpërdrejtë në pagat e 7 gjyqtarëve dhe të 25 këshilltarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Pa dyshim që kjo ka qenë e domosdoshme dhe përkthehet në një parashikim të rritje të buxhetit për vitin 2024. Nëse do të ndaleshim te një moment që u trajtua, për sa i përket parashikimit ligjor që kanë këshilltarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të cilët marrin shtesë për vështirësi në punë, në raport me kërkesën buxhetore që ne kemi bërë për tri paga, në planifikimin buxhetor për këtë vit na rezulton që është planifikuar vetëm për dy paga. Ritheksoj se ky është një parashikim ligjor, pra, vetë ligjvënësi e ka parashikuar këtë vështirësi për këshilltarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Shpresojmë që në momentin kur ju të votoni nën për nën të shikohet mundësia për plotësimin e kësaj kërkesë.

Për sa i përket çështjes së pasqyrimin të kërkesave tona, ne gjithmonë kemi respektuar detyrimin ligjor t'i drejtohem sipas ligjit Komisionit të Ligjeve; ai është parashikuar nga ligji si institucion, ku ne duhet të paraqesim kërkesat qoftë për strukturën, qoftë kërkesat buxhetore. E ripërsëris, në të gjithë veprimtarinë e tij Kolegji e ka zbatuar me korrektesë parashikimin ligjor në respekt edhe të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Klotilda Bushka - Faleminderit, zoti Çomo!

Këtë rrugë kemi ndjekur gjithmonë, ne kemi qenë komisioni përgjegjës. E thashë edhe një herë, veçanërisht me Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe me të gjitha organet e vetingut shoh që mbështetja e Kuvendit ka qenë gjithmonë e lartë. Ju keni kuptuar në nevojat që keni pasur dhe, sigurisht, neve na intereson që ju të jeni sa më eficientë në punën tuaj, t'i keni të gjitha mundësitë për t'i realizuar funksionet. Do të donim të shihnim sa më shumë çështje të evaduara, në mënyrë që të kapen afatet. Ju kujtoj se është shtyrë një herë afati i vetingut sa i takon shkallës së parë, kështu që do të duhet që të gjithë të kemi në konsideratë këtë fakt në realizmin e detyrave. Nëse nevojat që ju keni, u përgjigjen këtyre shqetësimeve, ne jemi të hapur, por do të duhet të diskutojmë patjetër me Ministrinë e Financave, sepse edhe kërkesa që ju përmendët për vështirësinë deri në tri paga, e thotë ligji, edhe ajo lidhet me nivelin e performancës së punës, pra, e vlerësoni ju, si Kolegj, sa do të jetë kjo pagesë. Kemi gjykuar, sa herë kemi bërë diskutime në lidhje me sasinë e pagave për vështirësinë në punë, që kjo është e lidhur me rezultatet e punës në këtë aspekt në institucionin tuaj.

Unë e di që ju jeni shumë më të qartë sesa unë, sepse merreni përditë dhe përballeni përditë me këto shqetësime të punës dhe i keni të gjitha argumentet për të komunikuar me Ministrinë e Financave, por edhe ne me praninë tonë si Komision Ligjesh, do të jemi prezent për të kuptuar nevojat dhe për të parë si përshtaten ato në ligjin e buxhetit të vitit 2024, si dhe çështje të tjera, për të cilat mund të jetë e domosdoshme asistenca e Komisionit, por edhe e Kuvendit, në mënyrë që të mos ketë probleme të pazgjidhura apo penguese në punën tuaj. Do t'i shohim shumë seriozisht me Ministrinë e Financave, me relatorët dhe me përfaqësuesit e institucionit. Pra, siç kemi bërë çdo vit, do të ketë mbledhje rakorduese para se të vijmë te momenti i miratimit në tërësi të buxhetit.

Laerta Rooze - A mund të shtoj diçka, zonja Bushka?

Klotilda Bushka - Po, zonja Rooze,

Laerta Rooze - E ndoqa me vëmendje trajtimin që u bë nga relatori, por edhe nga Ministria e Financave, nga zonja Çausholli, dhe nga pikëpamja teknike dua të sqaroj pjesën që u relatua lidhur me rritjen e buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit për vitin 2024.

Nga shifrat e buxhetit më rezulton që buxheti fillestar i miratuar për Kolegjin e Posaçëm të Apelimiti për shpenzimet e personelit ka qenë vlera 181,7 milionë lekë, ndërkohë që, ashtu siç tha edhe kryetari i Kolegjit, për shkak të rialokimeve të fondeve, që janë bërë gjatë vitit për të mbuluar efektet financiare dhe në funksion të zbatimit të vendimit 325, për rritjen e pagave, ashtu edhe të ndryshimeve në ligjin nr. 96/2016 "Për pagesën e gjyqtareve dhe këshilltarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", gjatë vitit është bërë i mundur alokimi i buxheteve shtesë dhe me këto buxhete, buxheti i rishikuar për Kolegjin e Posaçëm të

Apelimit për vitin 2023 ka arritur në 220,9 milionë lekë. Kjo do të thotë që buxheti paraprak, ose buxheti, i parashikuar në paketën e projektligjit për vitin 2024, në vlerën 218,2 milionë lekë është akoma më i ulët se buxheti i rishikuar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit për vitin 2023.

Nga ana tjetër, dua të them se sa i takon pagesës së vështirësisë së këshilltarëve të KPA-së, mundësia buxhetore deri tani ka qenë vetëm për dy paga, nuk është bërë e mundur asnjëherë që të zbatohet parashikimi që është në vendimin nr. 35/2022 të Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, ku pjesë e këtij vendimi është edhe parashikimi ligjor sa i takon pagesës së vështirësisë të këshilltarëve të njësisë së shërbimit ligjor.

Gjithashtu, në vijim edhe të asaj që kryetari i Kolegjit theksoi, dua të sjell në vëmendjen tuaj se buxheti që është parashikuar në shpenzime personeli për Kolegjin e Posaçëm të Apelit rezulton me një diferencë 17,5 milionë lekë, e cila pamundëson bërjen e pagesave për KPA-në për rreth një muaj. Prandaj do të jetë e nevojshme që të ketë një diskutim me Ministrinë e Financave dhe një rakordim të buxheteve, për të mos u ndodhur në situata që ne kemi qenë edhe vitet e kaluara, ku jemi detyruar të kemi komunikime të herëpashershme për të bërë të mundur rakordimin e buxheteve gjatë vitit dhe mbulimin e nevojave që KPA-ja ka.

Ju falënderoj!

Klotilda Bushka - Faleminderit, zonja Rooze, që ripërsëritët edhe një herë çështjet që u ngritën nga zoti Çomo!

Atëherë, mendoj se ishim të qartë. Do të duhet t’i rakordoni edhe një herë këto çështje me Ministrinë e Financave. Ne do të kemi një relacion nga relatorët për të kuptuar sesi do të adresohen shqetësimet dhe të ruajmë parimet e buxhetit. Ndërkohë, nëse keni ndonjë çështje tjetër, që nuk arritët ta thoni këtu, kijeni në konsideratë që në takimet që do të bëjnë relatorët me Ministrinë e Financave gjatë konsultimeve me ju, apo me shkëmbimin e shkresave, t’i adresoni edhe ato.

Ju falënderoj!

Kolegë, nëse nuk e do njeri fjalën, ne e kemi mbaruar mbledhjen e komisionit sot. Duke qenë se kemi mbaruar dëgjesat dhe pyetjet përkatëse, falënderoj zotin Çomo, zotin Verçani, zonjën Rooze dhe zonjën Çausholli!

Faleminderit, relatorëve!

Faleminderit, kolegëve!

Faleminderit stafeve të Kuvendit, teknikës dhe IT-së!

Kjo mbledhje deklarohet e mbyllur, për mbledhjen tjetër do të njoftoheni.
Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA